


KOMUNA ZALL DARDHË, QARKU DIBËR

Strategjia afatmesme e zhvillimit

2008–2015



Ky plan strategjik është hartuar nga disa grupe palësh të interesuara nga komuna Zall Dardhë nën drejtimin dhe këshillimin e ekspertëve të FLAG. FLAG nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e strategjisë, ndërkohë që përgëzon komunën dhe personat e përfshirë për cilësinë e punës së bërë.





Copyright © 2008 Komuna Zall Dardhë, Qarku Dibër

*Paraqitja grafike dhe shtypi
Maluka shpk*

Tabela e përmbajtjes

	Faqe
I. Parathënie.....	5
II. Metodologjia e përdorur	6
III. Përfitimet e pritshme nga zbatimi i Planit.....	9
IV. Zbatimi i Planit	9
V. Vizioni dhe synimet	10
VI. Sondazh i biznesit vendor	11
VII. Historiku i komunës.....	12
VIII. Tendencat e zhvillimit sipas sektorëve	15
IX. Analiza SWOT.....	21
X. Matrica e Planit Strategjik	24
XI. Formularët sipas fushave të zhvillimit.....	29
XII. Fish-Projekte.....	40
 Shtojcat	
Shtojca 1: Vendimi i Këshillit Komunal për miratimin e PSZh	59
Shtojca 2: Analiza e sondazhit me biznesin vendor.....	60



I. Parathënie

Nisma për hartimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të komunës Zall Dardhë me pjesëmarrje të gjerë, konsiderohet nga të gjithë të interesuarit si një domosdoshmëri për të kapur dhe përshpejtuar ritmet e zhvillimit ekonomik e social.

Komuniteti i Zall Dardhës shquhet në rang kombëtar për mirëkuptim dhe tolerancë dhe pavarësisht gjendjes ekonomike dhe sociale aktuale të rënduar, ka treguar dhe vazhdon të shpalosë virtytin e ndershmërisë dhe dashurisë për punën.



Njazi Cani

Kryetari i komunës Zall Dardhë

në këtë projekt, që me dashamirësi dhe përkushtim u bënë pjesë e përpjekjeve tona për të ndërtuar Planin Strategjik të Zhvillimit të komunës Zall Dardhë për periudhën 2008-2015.

Janë pikërisht cilësitë e larta njerëzore dhe mençuria në vlerësimin e situatave, ato që e bënë të lehtë arritjen e mirëkuptimit për të programuar bashkërisht Planin Afatmesëm të Zhvillimit bazuar në studimin e vlerave ekzistuese dhe aktivizimin e mundësive potenciale pa harruar eliminimin e dobësive dhe shmangien e rreziqeve.

Komunës së Zall Dardhës nuk i mungojnë kapacitetet njerëzore për të gjetur mënyrat më efektive për të realizuar vizionin e së ardhmes duke vlerësuar e përdorur ndihmën e ofruar nga organizatat dhe institucionet pjesëmarrëse

Më kënaq fakti se të gjithë pjesëmarrësit në procesin e hartimit të Strategjisë, përveç pjesëmarrjes aktive kanë shfaqur ndjenja optimizmi dhe besimi se zona jonë shpejt do të zhvillohet nëpërmjet punës së koordinuar, bashkëpunimit dhe shfrytëzimit me efektivitet të aseteve të shumta që zotëron territori ynë dhe komuniteti i Zall Dardhës.

- Kemi nevojë për rrugë dhe përmirësim infrastrukturash I kemi programuar dhe do t'i ndërtojmë
- Kemi mundësi për zhvillimin e blegtorisë Do ta zhvillojmë duke zbatuar projekte të mirëprogramuara
- Kemi mundësi për zhvillimin e bujqësisë dhe frutikulturës Kemi programuar shfrytëzimin e kësaj mundësie për ngritjen e nivelit ekonomik
- Kemi nevojë për zhvillimin e bizneseve Do t'i ndihmojmë ato të ngrihen e të zhvillohen si partnerë të qeverisjes vendore

- Kemi mangësi në aspektin social

Kemi programuar t'i riparojmë dhe të krijojmë një ambient të përshtatshëm për të punuar dhe jetuar

Kemi nevojë për kontributin e të gjithëve dhe deklaroj se qeverisja vendore ju mirëpret dhe ju mirëkupton pasi është e bindur se zhvillimi ekonomik i komunës kërkon zhvillimin sa më të shpejtë të pjesëtarëve të saj duke i ndihmuar ata në drejtim të organizimit dhe kryerjes së shërbimeve që ajo duhet t'i sigurojë komunitetit.

II. Metodologjia e përdorur

Hapat dhe veprimet në procesin e zhvillimit të Vizionit dhe Planit Strategjik të komunës, kanë patur parasysh se Vizioni është deklarata e përbashkët që komuniteti dhe aktorët e tjerë të komunës tentojnë të realizojnë për të ardhmen dhe se Plani Strategjik tregon se si do të bëhet realitet Vizioni. Ai specifikon synimet kryesore, objektivat, programet dhe projektet që do të mundësojnë arritjen e Vizionit. Ai i referohet buxhetit, burimeve njerëzore dhe çështjeve ligjore që lidhen me zbatimin e planifikuar.

Jemi të ndërgjegjshëm se vetë procesi i zhvillimit me sukses të Vizionit dhe Strategjisë ofron përfitime për komunitetin si: a) Bashkimin e komunitetit; b) Identifikimin e mundësive të reja për të ardhmen; c) Nxitjen e përfshirjes së banorëve në qeverisjen vendore; d) Zhvillimin e cilësisë së udhëheqjes së komunës; e) Sigurimin e një baze më të mirë për planifikimin dhe vendimmarrjen; f) Inkurajimin e përmirësimit të punës në partneritet; g) Arritjen e ndryshimeve konkrete në përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe mundësive ekonomike për komunitetin.

Gjatë fazave të mëposhtme u realizuan aktivitetet e mëposhtme:

Faza e përgatitjes

- Arritja e angazhimit politik nga Kryetari i komunës dhe pjesëtarë të tjerë të saj
- Krijimi i një grupi kryesuar nga Kryetari i komunës për të udhëhequr procesin
- Seleksionimi i drejtuesit dhe stafit të projektit
- Caktimi i temave ose grupeve të tjera që nevojiten për të mbështetur projektin
- Sigurimi i një ekspertize të jashtme
- Ndërtimi i projektplanit, me afatet kohore
- Përpilimi i një liste të aktorëve të mundshëm për t'u angazhuar në proces
- Informimi i Q.Q rajonale dhe njësive vendore fqinje për bashkëpunim
- Ngritja e grupeve mbështetëse sipas tematikave

Faza 1

- Përzgjedhja e të dhënave që do të mblidhen dhe burimi i tyre
- Mbledhja e të dhënave nga burimet e përcaktuara
- Analizimi i të dhënave për të identifikuar tendencat kryesore
- Krahasimi i të dhënave
- Përgatitja e një raporti të shkruar me karakteristikat kryesore të zonës
- Realizimi i një pyetësori drejtuar biznesit
- Përdorimi i profilit të komunitetit për të informuar analizën SWOT

Faza 2

- Realizimi i angazhimit të aktorëve dhe analiza e tendencave duke përdorur mbledhje të zgjeruara të Komisionit të Planit Strategjik dhe zhvillim të pyetësorëve drejtuar bizneseve
- Analizimi i gjetjeve nëpërmjet metodikës së “brainstorming”

Faza 3

- Draftimi i një Deklarate Vizioni, e cila përshkruan synimin e komunitetit, ku dallohet në mënyrë sintetike se si do të jetë komuna duke përdorur imagjinatën dhe kreativitetin si edhe bazuar në realitetin objektiv, të dhënat e grumbulluara rreth komunës, konsultimet me komunitetin dhe analizën e tendencave. Këtu dallohen anët e forta dhe mundësitë e identifikuara të zonës ku ndodhet komuna.
- Zhvillimi i analizës SWOT, synimi i së cilës është specifikimi i anëve të forta dhe të dobëta si cilësi të brendshme të komunitetit si edhe mundësive dhe rreziqeve që shkaktohen nga faktorë të jashtëm. Zhvillimi i analizës SWOT bazohet në të dhënat dhe informacionet e grumbulluara rreth komunës dhe të ardhmes së saj. Analiza u zhvillua nëpërmjet grupeve, mbledhjeve të komunitetit, duke përdorur “brainstorming” dhe të tjera teknika konsultimesh të lehtësuara.
- Finalizimi i Deklaratës së Vizionit pas realizimit të analizës SWOT dhe testimit të saj nëpërmjet grupeve dhe/ose mbledhjeve të komunitetit. SWOT përdoret si bazament për krijimin e Vizionit.

Faza 4

- Me krijimin e Deklaratës së Vizionit, nisja e punës për identifikimin e mënyrave për ta arritur Vizionin nëpërmjet Planit Strategjik, duke përcaktuar “si do të shkojmë atje?”
 1. U identifikuan synimet që janë më përshkruese dhe specifikuuese se ku duam të shkojmë
 2. Për çdo synim u përcaktuan objektivat për arritjen e tij
 3. Për çdo objektiv u identifikuan programe të mundshme
 4. Për çdo program u identifikuan projekte të mundshme

Projektet, me ndihmën e të gjithë të angazhuarve të mundshëm sipas mundësive, u paraqitën në formën e Fish-Projekteve, ku parashikohen implikimet financiare të burimeve njerëzore dhe ato të kuadrit ligjor, duke patur parasysh: a) vlerësimin nëse çdo projekt është realist dhe i arritshëm dhe se kush do të sigurojë burimet (financiare, njerëzore) për zbatimin e tyre dhe b) përgjegjësinë në zhvillimin e projektit.

- Përgatitja e draft-versionit final të materialit dhe miratimi në Këshillin e Komunës me vendim të veçantë

Mbetet detyrë e të gjithë aktorëve përfshirja në procesin e monitorimit dhe të vlerësimit të progresit gjatë zbatimit të Planit Strategjik.

III. Përfitimet e pritshme nga zbatimi i Planit

Përfitimet që priten si rezultat i zbatimit të Planit tonë Strategjik të Zhvillimit janë të shumfishta, por më kryesoret janë:

- Orientimi i Këshillit dhe administratës së Komunës në procesin e buxhetimit vjetor dhe afatmesëm duke u fokusuar në zbatimin e projekteve të përfshira në PSZh
- Fokusimi tek burimet njerëzore dhe financiare në fushat e identifikuara në Plan duke rritur maksimalisht përfitimet dhe mundësuar arritjen e synimeve dhe objektivave të PSZh
- Fuqizimi i partneritetit në vendimmarrje dhe bashkëfinancim mes qeverisë komunare dhe komunitetit të biznesit, qeverisë qendrore dhe donatorëve
- Rritja e kapaciteteve të administratës së bashkisë në zbatimin e një Plani Strategjik Zhvillimi
- Koordinimi i aktiviteteve të organizatave dhe institucioneve të cilat paraqesin interes në zbatimin e PSZh
- Dokumentimi i ecurisë së zhvillimit ekonomik në komunë duke përdorur formularët e sektorëve të zhvillimit
- Identifikimi i rezultateve të pritshme dhe krijimi i një sistemi monitorues në bashkëpunim me komunitetin, me qëllim ndjekjen e aktiviteteve dhe vlerësimin e rezultateve të parashikuara nga PSZh
- Zhvillimi i një sistemi efçent komunikimi mes qeverisë komunare dhe partnerëve të saj
- Lehtësimi i marketimit të potencialeve dhe të mundësive të të bërit biznes në komunë
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit në komunë në funksion të zbatimit të programeve dhe projekteve të PSZh
- Orientimi i qeverisë qendrore dhe donatorëve në dhënien e fondeve dhe në përqëndrimin tek burimet ekzistuese të disponueshme
- Arritja e ndryshimeve konkrete në përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe mundësive ekonomike për komunitetin

IV. Zbatimi i Planit

Ky është Plani Strategjik zyrtar për qeverinë komunare, institucionet dhe ndërmarrjet që ka nën varësi. Duke qenë se afati i zbatimit të Planit është më i gjatë se mandati politik, sukcesi i zbatimit të tij do të varet shumë nga angazhimi i vazhdueshëm i qeverisë komunare dhe partnerëve tanë në arritjen e objektivave dhe zbatimin e projekteve të përvijuara.

Këshilli Komunal, si faktori kyç në mbështetjen e PSZh, do të garantojë dhënien e fondeve për financimin e projekteve si edhe do të diskutojë dhe miratojë përmirësimet që do të sugjerohen nga Komisioni i Planit Strategjik dhe Kryetari i komunës.

Kryetari i komunës dhe personi direkt përgjegjës në administratë për ndjekjen e zbatimit të Planit Strategjik do të nxisin dhe koordinojnë përpjekjet, programet, projektet dhe financimet e qeverisë qendrore, donatorëve dhe organizatave vendase dhe të huaja në mënyrë që ata të ndjekin dhe mbështesin zbatimin e Planit. Përveç kësaj, Kryetari do të iniciojë dhe realizojë përmirësimet e nevojshme në menaxhimin e procesit dhe do të ristrukturojë stafin në funksion të zbatimit të Planit.

Suksesi i zbatimit të Planit do të varet më së shumti edhe nga mënyra se si organizatat dhe agjencitë e interesuara apo përfshira në zbatimin e Planit Strategjik do të menaxhojnë elementë të veçantë për të cilët ata janë përgjegjës.

V. Vizioni dhe synimet

VIZIONI

Qëllimi i përcaktimit të Vizionit për zhvillimin e komunës është që t'i mundësojë komunitetit tonë të artikulojë se ku ai dëshiron të jetë në të ardhmen dhe çfarë rruge do të ndjekë për të arritur të ardhmen e dëshiruar. Vizioni do t'i japë komunitetit dhe qeverisë komunare një ide të qartë se ku duhen përqëndruar energjitë dhe burimet e tyre.

Vizioni u zhvillua nga Komisioni i Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Komunës (KPZhS) pas konsultimeve me segmente të ndryshme të komunitetit. Synimi është që Vizioni të zhvillohet dhe të pranohet nga sa më shumë aktorë dhe grupe interesi si edhe të sigurojë një udhërrëfim të qartë drejt të ardhmes së komunës Zall Dardhë.

Ne besojmë se Vizioni i formuluar përmbledh në mënyrë realiste ambiciet, dëshirat dhe kapacitetet e komunës sonë. Ky Vizion do të jetë objekt rivlerësimi nga komuniteti, duke përfshirë vendimmarrësit në qeverinë vendore, për të reflektuar zhvillimet, ndryshimet dhe ndikimet në komunë.

VIZIONI I KOMUNËS ZALL DARDHË

Komuna Zall Dardhë në vitin 2015, do të jetë një komunë ku garantohet qeverisja dhe infrastruktura cilësore për arritjen e zhvillimit ekonomik e social në nivele të kërkuara nga komuniteti dhe si rezultat i rritjes sasimore dhe cilësore të prodhimit bazuar në burimet natyrore të zonës, kryesisht ai blegtoral dhe bujqësor, do të mundësojë sigurimin e tregut dhe të ardhura të larta për komunitetin nëpërmjet bizneseve të suksesshme.

SYNIMET

Përcaktimi i synimeve të ZhEV na ndihmon të marrim vendime lidhur me rrugët dhe mënyrat për të arritur ambiciet dhe ndryshimet që nevojiten. Megjithëse disa nga synimet dhe veprimet për arritjen e tyre nuk lidhen direkt me krijimin e vendeve të punës dhe me zhvillimin dhe tërheqjen e bizneseve, e ardhmja e komunitetit tonë bazohet mbi themele të shëndosha si niveli i arsimimit dhe cilësia e jetesës, infrastruktura dhe shërbimet komunale. Në konceptin tonë, bizneset nuk zhvillohen, nuk lulëzojnë dhe nuk mund të tërhiqen në komunitete, kur nuk ofrohen nivele dhe cilësi të përshtatshme të infrastrukturës dhe shërbimeve që kërkon një mjedis i mirë për zhvillimin e biznesit.

Për të arritur synimet e ZhEV, komuna jonë është përqëndruar në përdorimin e burimeve të veta natyrore dhe njerëzore. Për zhvillimin e synimeve, Komisioni i Planit Strategjik mori parasysh mundësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet komuna, historinë e vet të zhvillimit ekonomik dhe të rajonit.

Synimet e ZhEV shprehin drejtimet kryesore që do të ndjekë zhvillimi i komunës. Këto janë renditur më poshtë sipas rëndësisë për zhvillimin vendor dhe krijimit të një mjedisi të favorshëm për zhvillim të qëndrueshëm. Ato janë zhvilluar nëpërmjet një analize logjike të kujdesshme të Vizionit dhe trajtojnë çështje thelbësore për zhvillimin e komunës.

Matrica në vazhdim prezanton në mënyrë të organizuar Strategjinë e Zhvillimit, nga Vizioni tek Projektet, duke mundësuar një fotografim të ambicieve, përpjekjeve dhe iniciativave të komunitetit dhe qeverisë komunare që mundësojnë zbatimin e Strategjisë dhe zhvillimin ekonomik të komunës.

Synimi 1:

Garantimi i shërbimeve qeverisëse bashkëkohore që mundëson administrim efektiv dhe eficient të aseteve publike dhe krijon kushtet për zhvillimin njerëzor dhe social-ekonomik të qëndrueshëm në komunë.

Synimi 2:

Sigurimi i standarteve normale për infrastrukturën dhe shërbimet publike në të gjithë komunën, për t'i paraprirë dhe mbështetur zhvillimit ekonomik dhe social.

Synimi 3:

Shtimi i llojshmërisë dhe qëndrueshmërisë së bizneseve prodhuese, përpunuese dhe tregtuese në komunë duke shfrytëzuar potencialet natyrore, avantazhet e zonës dhe modelet efektive të bashkëpunimit në biznes.

VI. Sondazh i biznesit vendor

Në komunën Zall Dardhë u realizua një sondazh me biznesin vendas për të kuptuar më mirë shqetësimet, pritshmëritë dhe nevojat e biznesit. Synimi i sondazhit ishte mbledhja e informacionit të sistemuar mbi vlerësimin e komunitetit të biznesit në lidhje me situatën ekonomike në komunë, perspektivën e të bërit biznes në komunë, kushtet dhe rregullat që ndikojnë në zhvillimin e bizneseve vendase, politikat dhe praktikrat që pengojnë zhvillimin e bizneseve ekzistuese, si edhe kërkesat dhe nevojat e komunitetit për përmirësimin e klimës së biznesit. Sondazhi mbi Klimën e Biznesit u zhvillua në muajin Tetor 2007 dhe në të morën pjesë 23 biznese nga kategori të ndryshme.

Perceptimi kryesor i bizneseve është se qeveria komunare nuk ka mjetet dhe autoritetin e duhur për të ndihmuar zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ky perceptim mund të jetë shkak i komunikimit dhe dialogut të varfër midis qeverisë komunare dhe biznesit.

Gjatë diskutimeve, përfaqësuesit e biznesit shprehën dëshirën që të viheshin në dispozicion më shumë burime financiare për autoritetet vendore, në mënyrë që të rritej kapaciteti dhe mundësia e tyre për të përkrahur zhvillimin ekonomik në komunë.

Përfshirja e opinioneve të biznesit në formulimin e Planit Strategjik ishte një hap i rëndësishëm në hapjen e procesit të vendimmarrjes. Nëpërmjet këtij hapi, u shqyrtuan opinionet e një grupi njerëzish me influencën më të madhe mbi zhvillimin ekonomik në komunë.

VII. Historiku i komunës

Zall Dardha shtrihet në një trevë të lashtë, ku emri Dardhë është një fjalë shqipe dhe nuk ka nevojë të gërmosh për të gjetur etimologjinë e saj.

Qyteti i lashtë kryesor i kësaj zone ishte Dapatra, i cili dëshmon se kjo zonë ka qenë një vendbanim i lashtë dhe janë zbuluar dhe njihen gjurmë të hershme të lashtësisë, ku mund të përmendim Çukun e Lekës, Mejen e Qytetit, Kishën e Dom Mjësit dhe Merskanës, Trojet e Mjeshtit etj.

Pozicioni i favorshëm gjeografik dhe zhvillimi i saj kanë tërhequr të huajt. Mbrojtja e saj ka detyruar luftra që kanë mbetur në histori, si p.sh. kryengritja ndaj turqve 1560 -1570, kundër tanzimatit 1839-1870, lëvizja për autonomi dhe shkëputje nga Perandoria Osmane 1875-1912, kundër pushtuesve serbë, bullgarë dhe austro-hungarezë e deri tek lufta ndaj okupatorëve nazifashistë.

Kjo zonë njihet si një ndër zonat më patriotike, ku spikat "dernjani" si malësor tipik me vlera trimërore dhe burrërore por edhe i shkathët, i lirshëm, i këndshëm, i zgjuar dhe punëdashës. Ka karakter të fortë, shpërthyes dhe sedërli. Situatat e vështira i përballon me maturi.

Relievi mund të përshkruhet si një shpatore e mbushur me kodra e fshatra në një sfond të gjelbëruar, e cila nis e bie nga maja e Gjargjishtit dhe Pllaja e Lana-Lurës deri në brigjet e Drinit të Zi, nga Mustafja deri në Kraj-Reç. Kjo zonë është e pasur me burime natyrale uji.

Nga pikëpamja administrative, gjatë regjimit komunist ajo ka qenë kooperativë, kurse me ndryshimet demokratike dhe sot e kësaj dite është njësi vendore e nivelit të parë ose komunë e përbërë nga 9 fshatra:

1. Zall Dardhë me 610 banorë, 124 familje me 139 ha tokë bujqësore e 238 ha kullota
2. Lugjej me 630 banorë, 124 familje me 139 ha tokë bujqësore e 142 ha kullota
3. Tartaj me 380 banorë, 54 familje me 54.1 ha tokë bujqësore e 185 ha kullota
4. Shënllëshën me 34 banorë, 8 familje me 28 ha tokë bujqësore e 100 ha kullota
5. Nezhaj me 278 banorë, 57 familje me 89.3 ha tokë bujqësore e 140 ha kullota
6. Mënesh me 68 banorë, 11 familje me 43.7 ha tokë bujqësore e 66 ha kullota
7. Lashkizë me 231 banorë, 47 familje me 83.7 ha tokë bujqësore e 53 ha kullota
8. Soricë me 158 banorë, 21 familje me 67.5 ha tokë bujqësore e 57 ha kullota
9. Qa me 31 banorë, 6 familje me 63 ha tokë bujqësore e 29 ha kullota

Historikisht, ekonomia e kësaj zone është bazuar tek blegtoria, kryesisht ajo e imët dhe bujqësia e pemëtaria. Niveli i shkëmbimeve është shtrirë edhe përtej kufinjve të Dibrës. Zona, në përqindjen më

të madhe të kohës, ka prodhuar kryesisht për nevoja vetiake por ka mundësi potenciale të shumëfishojë prodhimet në një sërë artikujsh. Pengesë për rritjen e nivelit të shkëmbimeve gjithmonë është shfaqur infrastruktura rrugore dhe për prodhimet bujqësore, mangësitë në drejtim të ujitjes dhe kullimit.

Zona e Dardhës konsiderohet si djepi i folklorit për Dibrën. Ajo ka nxjerrë shumë artistë, artistë të merituar dhe mjeshtra arti. Kjo traditë ka një rënie kohët e fundit por është në vëmendjen e të gjithë komunitetit ruajtja dhe mundësisht zhvillimi i saj.

Tradita e ndërtimit të marrëdhënieve në mënyrë demokratike është e spikatur, ku vlen të përmendet lidhja e besës së “15 burrave të dheut” dhe nën shembullin e tyre shmangia totale e zakonit të gjakmarrjes në ditët e sotme.

Bazuar në cilësitë e mrekullueshme të banorëve dhe pasuritë natyrore të kësaj zone, shpejt Zall Dardha do të zhvillohet duke punuar dhe bashkëpunuar në mënyrë të organizuar.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI KOMUNËN

Komuna

ZALL DARDHË

ndodhet

33

km

larg qytetit të

PESHKOPIË

Qarku

DIBËR

Të ardhurat vjetore mesatare për frymë

19,116

Lekë/
vit

Të ardhurat vjetore nga taksat lokale të mbledhura nga Komuna

219,000

Lekë

Të ardhurat vjetore të planifikuara për vitin në vazhdim nga taksat lokale

224,000

Lekë

Shpenzimet vjetore për infrastrukturën për vitin 2006 janë

360,000

Lekë

Sip. e Komunës

3086

ha

Harta Topografike 1:25000 (Nomenklatura)

K-34-77-D-a

K-34-77-D-c

Nr.	Fshatrat	Nr. i banorëve	Nr. i familjeve	Nr. i familjeve të ardhura	Nr. i familjeve të larguara	Nr. i emigrantëve	Nr. i mjeteve	Nr. i nxënësve	Nr. i fëmijëve deri 6 vjeç	Sipërfaqe bujqësore (ha)	Sipërfaqe kullote(ha)	Nr. i familjeve me ndihmë ekonomike	Vizita të kryera në vit në Qendrat Shëndetësore	Nr. i mësuesve	Nr. i mjekëve	Nr. i infermierëve	Nr. i njësive tregtare
1	Zall Dardhë	610	124	7	11	15	4	161	59	139	238	50	2200	12	1	2	3
2	Lugjej	630	127	6	8	18	3	31	61	212.7	142	42	0	4	0	1	2
3	Tartaj	380	54	5	7	8	1	9	27	54.1	185	28	0	1	0	1	1
4	Shënleshën	34	8	0	2	2	0	0	4	28	100	5	0	0	0	0	0
5	Nezhaj	278	57	2	5	8	1	11	25	89.3	140	27	0	1	0	1	0
6	Mënesh	68	11	1	1	0	2	4	4	43.7	66	5	0	1	0	0	0
7	Lashkizë	231	47	3	6	6	3	38	18	83.7	53	25	0	6	0	1	0
8	Soricë	158	21	4	6	4	0	7	7	67.5	57	11	0	1	0	1	0
9	Qa	31	6	0	1	0	0	0	3	63	29	0	0	0	0	0	0
	Shuma e Komunës	2420	455	28	47	61	14	261	208	781	1010	193	2200	26	1	7	6

TË DHËNA TEKNIKE MBI KOMUNËN

<i>Gjendja teknike e infrastrukturës publike nën juridiksionin e komunës:</i>		Nr.	Emërtimi i investimit	Kosto (lekë)
1. Rrugë rurale	gjithsej	30.7		km
Të rikonstruatuara		11.3		km
Të parikonstruatuara		19.4		km
2. Rrugë urbane	gjithsej	13		km
Të rikonstruatuara		13		km
Të parikonstruatuara				km
3. Ujësjellës	gjithsej			copë
Të rikonstruuar				copë
Të parikonstruuar				copë
4. Shkolla	gjithsej	5		copë
a) Të rikonstruatuara		1777		m ²
Sipërfaqe ndërtese		3549		m ²
Sipërfaqe oborri		0		copë
b) Të parikonstruatuara		471.6		m ²
Sipërfaqe ndërtese				m ²
Sipërfaqe oborri				m ²
5. Qendra Shëndetësore	gjithsej	1		copë
Të rikonstruatuara		40		m ²
Të parikonstruatuara				m ²
6. Kanalizime të ujërave të zeza	gjithsej			km
Të rikonstruatuara				km
Të parikonstruatuara				km
7. Kanale ujitëse	gjithsej			km
Të rikonstruatuara				km
Të parikonstruatuara				km
8. Tregje publike	gjithsej			copë
Të rikonstruatuara				m ²
Të parikonstruatuara				m ²
9. Parqe & hapësira të gjelbërta	gjithsej			m ²
Të rikonstruatuara				m ²
Të parikonstruatuara				m ²

VIII. Tendencat e zhvillimit sipas sektorëve


1. Të dhëna të përgjithshme:

- Qarku i Dibrës ka një dendësi mesatare 73.4 banorë/km² kurse komuna Zall Dardhë 78.4 banorë/km².
- Pas viteve '90 popullsia e qarkut Dibër është zvogëluar me mesatarisht 16% për shkak të emigrimit jashtë vendit e migrimit brenda vendit. Nga llogaritja e familjeve të larguara nga komuna del se ato përbëjnë aktualisht rreth 9% të popullsisë së komunës.
- Në qarkun e Dibrës trajtohen me ndihmë ekonomike afërsisht 21% e familjeve kurse në komunën e Zall Dardhës aktualisht 42% e familjeve trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Nga e gjithë sipërfaqja e komunës, 25% është tokë bujqësore, 33% kullota. Mesatarisht, toka bujqësore për çdo familje është në shifrën 1.72 ha/familje kurse në rang qarku kjo shifër është 0.94 ha/familje.
- Burimet e të ardhurave të familjeve kryesisht vijnë nga ndihma ekonomike, nga shitje të produkteve të tepërta në mënyrë jo të organizuar, nga emigracioni dhe punësimi apo vetëpunësimi. Të ardhurat për frymë në ditë nuk mund të llogariten saktësisht por afërsisht arrijnë në 130 lekë për frymë në ditë.



2. Administrimi dhe qeverisja vendore

Administrata e komunës ZALL DARDHË përbëhet nga 12 punonjës të inkuadruar sipas skemës së mëposhtme organizative:



3. Bujqësia

Në komunën e Zall Dardhës, sot janë të mundshme për përdorim rreth 781 ha tokë për prodhimet bujqësore, për dru-frutorët 6 ha, për sipërfaqe vreshtash 2 ha, për sipërfaqe të shfrytëzuar për kullota 1010 ha, për foragjeret rreth 280 ha tokë.

Sot afërsisht prodhohen për treg fasule 100 kv, arra 100 kv, misër 400 kv, patate 150 kv, raki rreth 40 kv. Rreth 50% e familjeve tregtojnë teprica prodhimi në sasi të vogla. Në treg, gjithashtu, dalin bimë medicinale të mbledhura nga rreth 15% e familjeve të komunës dhe kryesisht sherbelë rreth 50 kv, kamomil rreth 5 kv, lule njëmijëfletëshe rreth 5 kv, lule shtogu 5 kv dhe bimë të tjera medicinale në sasi të vogla.

Duke u nisur nga tradita e prodhimeve bujqësore ekzistojnë mundësitë e rritjes së prodhimit për treg të prodhimeve. Kështu, prodhimi i fasules mund të dyfishohet, i patates mund të katërfishohet, i misrit mund të trefishohet, i kumbullës, mollës dhe rrushit mund të trefishohet. Kurse grumbullimi i bimëve medicinale mund të pesëfishohet. Ka tendenca për kultivimin e lajthisë së butë, e cila është evidentuar si një prodhim që mund të kultivohet me sukses dhe që ka treg të leverdisshëm.

Këto prodhime janë të mundshme nëse rikonstruktohet sistemi vaditës, pasi vetëm 35% e tokës është nën ujë, shtohen mundësitë me anë të kredimarrjes, mekanikës bujqësore si edhe trajnimit të fermerëve për krijimin e sipërfaqeve të reja me këto prodhime, krahas futjes së bimëve me rendiment të lartë. Nevojiten, gjithashtu, ndërtimi i pritave mbrojtëse. Një tjetër veprim që duhet kryer është organizimi dhe sigurimi i tregut të prodhimeve të pritshme. Gjithashtu, mund të mendohet për krijimin e një tregu zonal për prodhimet bujqësore.

4. Blegtoria

Sot në komunën e Zall Dardhës ka rreth 3000 bagëti të imta dhe një tendencë rritjeje deri në 6000 krerë të imta (dhi dhe dele). Numri i krerëve të gjedhit është dyqind dhe mund të shkojë deri në pesëqind. Rriten shpendë të ndryshme, kryesisht pula rreth 2000 krerë dhe ekziston mundësia e rritjes së këtij numri deri në 5000 krerë. Në këtë komunë rriten edhe bletë dhe prodhohet rreth 15 kv mjaltë, sasi e cila mund të katërfishohet.

Rreth 50% e familjeve të komunës tregtojnë produkte blegtorale. Në treg nxirret rreth 200 kv mish viçi, 100 kv mish keci dhe 120 kv mish qingji. Qumështi nuk del në treg pasi transporti është i vështirë dhe i kushtueshëm. Qumështi përpunohet dhe në treg del rreth 100 kv gjizë dhe 10 kv gjalpë. Në treg dalin gjithashtu rreth 400 krerë shpendë dhe rreth 3000 kokrra vezë.

5. Infrastruktura rrugore

Infrastruktura rrugore është në një nivel që lë shumë për të dëshiruar dhe në një masë të konsiderueshme bëhet faktor pengues i biznesit prodhues dhe tregtues. Kështu, për të shkuar në qendër të komunës duhet përshkuar 33 km nga qyteti i Peshkopisë, 2/3 e së cilës është e paasfaltuar dhe në gjendje të keqe. Në të gjithë territorin e komunës ka 30.7 km rrugë rurale, ku vetëm 11.3 km janë të rikonstruara. Ka 13 km rrugë të brendshme urbane.

Përmirësimi i situatës mendohet të fillojë me shtrimin me asfalt të segmentit të rrugës nacionale Muhurr-Zall Dardhë. Gjendja e rrugëve konsiderohet faktor kyç për zhvillimin ekonomik të zonës. Rrugët e komunës kanë bazament të konsoliduar dhe premtojnë investime me cilësi të garantuar. Ndërtimi i një ure lidhëse mbi lumin Drin i Zi do ta bënte komunën e Zall Dardhës vend tranzitor për zonat e Lurës dhe të Reçit. Kjo urë shkurton në mënyrë të ndjeshme distancën për në qytetin e Peshkopisë.

6. Furnizimi me ujë dhe energji elektrike

Nga nëntë fshatra që ka kjo komunë, me ujë të pijshëm nëpërmjet ujësjellësve, nuk furnizohet asnjë fshat. Është evidentuar nevoja dhe mundësia e furnizimit me ujë të pijshëm nëpërmjet ndërtimit të ujësjellësve. 100% e komunitetit shfrytëzon për ujë të pijshëm burimet e vogla natyrore pranë qendrave të banimit.

Komuna e Zall Dardhës furnizohet me energji elektrike nga n/stacioni i Fushë Çidhnës dhe rrjeti i shpërndarjes së energjisë është funksional. Ekzistojnë në gjendje të mirë pune shtatë kabina elektrike dhe shtatë transformatorë. Ajo që duhet riparuar është shtimi i orareve të furnizimit me energji elektrike. Kjo justifikuar edhe me nivelin e ulët të humbjeve jo teknike dhe rregullshmërisë së pagimit të energjisë në masën 90% nga banorët. Konsumi mesatar i energjisë elektrike është afërsisht 40 kW/orë për çdo banor në muaj.

7. Transporti dhe telekomunikacioni

Nevojat e komunitetit për transport udhëtarësh në drejtim të Peshkopisë, ndërmjet fshatrave të komunës si edhe transporti i nxënësve për në shkolla realizohet me pesë furgonë, të cilët janë pronë private e disa personave. Këta të fundit i përdorin ato jo rregullisht dhe për t'u quajtur biznes i mirëfilltë, pasi gjendja e rrugëve dhe niveli i të ardhurave të banorëve sjell një marzh shumë të ulët fitimi. Kjo edhe për faktin se numri i udhëtarëve është shumë i ulët. Vetëm një furgon dhe një minibuz janë regjistruar si biznese transporti deri tani. Edhe transporti i mallrave bëhet me disa mjete pronë private që aktivizohen në mënyrë sporadike dhe për sasi të vogla.

Telekomunikacioni është në nivel shumë të ulët, pasi nuk ka zyrë postare, nuk ka linja të telefonisë fikse por operohet vetëm me operatorët celularë. Në këto kushte, për internetin nuk mund të flitet.

Valët televizive vijnë vetëm nëpërmjet antenave personale, pasi nuk ka ripetitor që të mundësojë mbulimin e kësaj zone me sinjalet e TVSH-së.

8. Arsimi dhe zhvillimi profesional

Në komunën e Zall Dardhës ka nëntë shkolla, nga këto një është e mesme e përgjithshme, tre janë 9-vjeçare dhe pesë të ciklit të ulët. Aktualisht numri i nxënësve gjithsej është dyqind e shtatëdhjetë e tetë. Rastet e mosfrekuentimit të arsimit të detyrueshëm janë dhjetë. Në komunë ka një mësues për çdo dymbëdhjetë nxënës (278 nxënës:23 mësues). Distanca e përshkruar nga nxënësit që frekuentojnë arsimin e mesëm është relativisht e madhe për t'u përshkruar në këmbë. Arsimin e lartë, kryesisht në Tiranë, e frekuentojnë aktualisht dy nxënës, një prej të cilëve sapo e ka filluar këtë vit shkollor.

Është evidentuar nevoja e trajnimit të personelit mësimdhënës dhe plotësimi i bazës didaktike në shkolla. Është e nevojshme organizimi i një biblioteke letrare dhe shkencore në ambientet e shkollës së mesme, e cila mund t'i shërbejë nxënësve dhe banorëve të tjerë jashtë orarit të zhvillimit të mësimin.

Synohet nxitja e arsimit profesional dhe mendohet që 85% e nxënësve që mbarojnë arsimin 9-vjeçar të ndjekin arsimin e mesëm profesional dhe 30% e atyre që mbarojnë arsimin e mesëm të ndjekin arsimin e lartë. Gjithashtu, është evidentuar nevoja për nxitjen dhe organizimin e arsimit parashkollor nëpërmjet iniciativave private. Zhvillimi profesional është i pallogaritshëm, pavarësisht se nevoja për të është e domosdoshme dhe e kërkuar nga banorët të cilët janë të ndërgjegjshëm për rritjen e domosdoshme të nivelit të tyre profesional për të përballuar sfidat e zhvillimit.

Nga ana e Komunës po mendohet të planifikohet mundësia e zhvillimit profesional në fushat më prioritare, nëpërmjet ngritjes së një njësie për organizimin e kualifikimeve duke filluar që nga menaxhimi ekonomik i aktiviteteve dhe duke vazhduar me kurse të tjera sipas nevojave të evidentuara. Një objektiv afatshkurtër është vënia në funksionim e një ambienti pranë shkollës së mesme, i cili mund të shfrytëzohet edhe për kualifikimin e administratës publike dhe banorëve që kanë nevojë për kualifikim.

Konsiderohet si një kërkesë e kohës edhe ngritja e kurseve për gjuhë të huaja.

9. Shëndetësia

Në komunën e Zall Dardhës ekziston një Qendër Shëndetësore funksionale dhe dy ambulanca me një personel infermier prej shtatë punonjësish dhe një mjeku familjeje. Numri i vizitave të kryera nga kjo Qendër është rreth dy mijë e dyqind në vit.

Ndihet nevoja për rritjen e kujdesit shëndetësor, si në sasi ashtu edhe në cilësi. Gjithashtu, kërkohet pajisja me mjetet e domosdoshme dhe vënia në funksionim e dy ambulancave në fshatrat Lugje dhe Nezhaj. Nevojitet trajnimi i personelit për të arritur parametrat mesatarë të shërbimit shëndetësor parësor në drejtim të:

- a) Trajtimit të sëmundjeve infektive
- b) Kujdesit për Nënë dhe Fëmijën
- c) Trajtimit të urgjencave në kushtet e shërbimit shëndetësor parësor
- d) Planifikimit familjar dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme

Shëndeti i popullatës konsiderohet i mirë dhe shmangia e distrofisë është në qendër të vëmendjes pasi niveli i dobët ekonomik mund ta favorizojë këtë sëmundje. Aktualisht, ka pesëdhjetë të sëmurë kronikë ose 0.5 në 1000 banorë.

Niveli i lindjeve është i ulët dhe me tendencë rënieje, edhe pse vdekshmëria foshnjore është gati zero. Rritja natyrale është e vogël, ashtu si edhe ajo mekanike.

Konsiderohet problem për t'u zgjidhur sa më shpejt mundësimi i lidhjes së shërbimit parësor në komunë me shërbimin spitalor duke u nisur nga fakti se gjendja e infrastrukturës rrugore është e dobët dhe mungojnë mjetet profesionale të transportit të të sëmurëve.

10. Biznesi

Për sa i përket biznesit, ai aktualisht përfaqësohet me njësitë tregtare dhe shërbimet, të cilat shkojnë deri në gjashtë të tilla. Biznesi, në kuptimin e mikrofermave, nuk është evidentuar pasi niveli i daljes në treg me prodhime vendase është shumë i ulët për t'u konsideruar si biznes i mirëfilltë.

Evidentohet nevoja për trajnim në menaxhimin e potencialeve bujqësore dhe blegtorale të familjeve në këtë komunë. Gjithashtu, çelja e bizneseve të reja prodhuese, përpunuese apo edhe tregtuese është e lidhur me nivelin e prodhimit dhe të të ardhurave ekonomike.

Në komunën e Zall Dardhës është regjistruar një biznes i transportit të mallrave dhe pasagjerëve. Janë evidentuar dhe janë në proces regjistrimi katër biznese me drejtim tregtar, gjashtë prodhues, katër biznese shërbimesh dhe një biznes grumbullimi bimësh medicinale. Të ardhurat nga taksa vendore e biznesit të vogël për 9-mujorin 2007 arrijnë në 30,000 lekë, nga taksa e përdorimit të tokës 60,000 lekë, nga taksa e ndërtesës janë mbledhur 20,000, nga ajo e regjistrimit të automjeteve 20,000 lekë. Biznesi i prodhimit bujqësor dhe blegtoral është i pa-evidentuar ende, pasi sasia e daljes në treg është e vogël dhe shitjet janë sporadike. Nga katërqind e pesëdhjetë e pesë familje, tregtojnë teprica të prodhimit rreth 60% e tyre.

Pritet konsolidimi i bizneseve të lidhura me prodhimet bujqësore dhe blegtorale të 60% të familjeve. Gjithashtu, pritet zhvillimi i bizneseve përpunuese, atyre të grumbullimit dhe përpunimit të bimëve medicinale, prodhimit të mjaltit si edhe bizneseve të lidhura me shërbimet që mungojnë në territorin e komunës. Evidentohet vullneti për organizimin e fermerëve për grumbullimin dhe tregtimin e produkteve të paraplanifikuara. Iniciativat për zhvillimin profesional dhe menaxhimin ekonomik do të ndihmonin arritjen e objektivave të zhvillimit ekonomik të komunës.

11. Vlerësimi i potencialeve turistike

Afërsia me Bjeshkët dhe zonën e Lurës përbën një potencial të mundshëm për të menduar rreth aktivizimit të turizmit malor familjar, veror dhe dimëror. Ky potencial është i mundur pas përmirësimit të situatës së rrugëve lidhëse me këto zona. Krijimi i parqeve ku mund të kultivohen kafshë dhe shpendë të egra, shfaqet si një opsion i mundshëm për t'u realizuar dhe si burim zhvillimi i turizmit. Gjithashtu, mund të organizohet shfrytëzimi i brigjeve të ulta të lumit Drin i Zi si mikroplazhe verore.

IX. Analiza SWOT

S-Anët e forta që janë identifikuar si mbështetje për zhvillimin e komunës

PRODHIME BUJQËSORE DHE BLEGTORALE TË TESTUARA EDHE NË TË KALUARËN

Kjo zonë është shquar për prodhime bujqësore dhe blegtorale me rendiment të lartë. Prodhimet e pemëtarisë kanë qenë të shumëllojshme dhe nga kjo zonë janë furnizuar edhe zona të tjera të Shqipërisë dhe duke patur cilësi të mirë janë eksportuar edhe jashtë vendit.

VLERAT MJEDISORE

Vlerat mjedisore të zonës vazhdojnë të jenë të larta, pasi pothuajse mungojnë ndotjet e ndryshme aq shqetësuese për shumë zona të tjera. Klima është shumë e përshtatshme për gati të gjithë gamën e prodhimeve bujqësore. Reshjet e shumta, burimet natyrore dhe afërsia me lumin Drin i Zi si edhe tokat pjellore favorizojnë zhvillimin e bujqësisë dhe pemëtarisë. Zona është e pasur me pyje dhe kullota shumë të përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë.

TRADITA E PUNËS DHE ARSIMIMIT

Banorët e zonës e kanë traditë brez pas brezi dhe kanë kualifikimin e nevojshëm në drejtim të punëve bujqësore dhe blegtorale. Gjithashtu, banorët e zonës njihen historikisht si arsimdashës dhe të zgjuar. Banorët e kësaj zone kanë dhënë prova për iniciimin, realizimin dhe zbatimin e marrëveshjeve me zonat përreth për mbrojtjen e përbashkët të pronave të tyre.

STRUKTURA E ZONËS

Afërsia me Bjeshkët dhe zonat turistike si edhe shumëllojshmëria e florës dhe faunës, mund të shfrytëzohen për ndërtimin e parqeve natyrore, ku kultivimi i kafshëve të egra në një ambient shumë të përshtatshëm natyror, mund të tërheqë turistë dhe të apasionuar pas gjuetisë dhe alpinizmit. Aktivitetet e kësaj natyre mund të zhvillohen në të gjitha stinët e vitit.

SHUMËLLOJSHMËRIA E FLORËS

Flora e kësaj zone është e pasur me shumë bimë të kërkuara nga industria farmaceutike si edhe me bimë të egra, si lajthia e egër që kërkohet shumë nga tregu ndërkombëtar. Klima e përshtatshme bën të mundur edhe kultivimin e lajthisë së butë, gjithashtu e kërkuar nga tregu i huaj dhe vendas.

VULLNETI I AUTORITETEVE VENDORE DHE QENDRORE

Identifikohet lehtë angazhimi i autoriteteve të qeverisjes vendore dhe qendrore në iniciativat zhvilluese të komunitetit duke shfaqur një vullnet bashkëpunimi me të gjithë aktorët e mundshëm për arritjen e niveleve më të larta të zhvillimit ekonomik.

W-Mundësitë që mund të shfrytëzohen në funksion të zhvillimit

MUNDËSITË E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Bashkëpunimi me investitorë vendas dhe të huaj, pa përjashtuar diasporën, si edhe vetitë organizative, promovuese dhe bashkëpunuese mund të bëjnë të mundur zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e turizmit malor, shoqëruar me zhvillimin e sporteve dimërore dhe gjetisë. Kjo mundësi potenciale bazohet në strukturën e përshtatshme të relievit, faunës dhe florës së kësaj zone si edhe në tendencën e përmirësimit të infrastrukturës rrugore, furnizimit me ujë dhe energji elektrike si edhe komunikimit.

MUNDËSIA E RITJES SË BIZNESEVE ME PËRDORIMIN E MIKROKREDIVE

Sigurimi i mikrokredive nga institucionet bankare që veprojnë në qendrën e qarkut dhe mbulojnë këtë zonë po bëhen gjithnjë edhe më të mundshme dhe lehtësisht të realizueshme. Kjo mundësi bazohet edhe në politikat e zhvillimit që kanë qeverisja qendrore dhe ajo vendore, të cilat inkurajojnë bizneset bankare në kreditimin e fermerëve me synim mbështetjen e zhvillimit ekonomik të zonave rurale.

RRITJA E SASISË SË PRODHIMEVE TRADICIONALE NGA FERMERËT

Cilësia dhe sasia e tokës, klima, organizimi i mikrofermave dhe sigurimi i ujitjes mund të garantojnë rritjen e prodhimit të të gjitha produkteve bujqësore dhe pemëtarisë tradicionale. Nga eksperiencat e mëparshme mund të themi se prodhimi, minimalisht mund të dyfishohet ose trefishohet. Të njëjtën gjë mund të themi për prodhimet blegtorale tradicionale, bazuar në kullotat e përshtatshme dhe prodhimin e foragjereve.

MUNDËSIA E PRODHIMEVE TË REJA APO PAK TË ZHVILLUARA NË ZONË

Eksperiencat e testuara tashmë nga biznese sporadike tregojnë mundësinë potenciale për zhvillimin e prodhimit të mjaltit cilësor dhe lajthisë. Zhvillimin e prodhimit të këtyre produkteve e garanton edhe cilësia dhe sasia e burimeve ujore, pasuria e faunës dhe florës si edhe sipërfaqet dhe relievi i përshtatshëm për kultivimin e tyre.

APLIKIMI I MODELEVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET FERMERËVE

Një mundësi potenciale për zhvillimin ekonomik të zonës është edhe shfrytëzimi i eksperiencave ndërkombëtare të organizimit të bashkëpunimit në prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve. Kjo mundësi favorizohet edhe nga mundësia e zhvillimit profesional e menaxhues që planifikohet të sigurohet me ndihmën e qeverisjes vendore dhe asaj qendrore.

ZHVILLIMI I BIZNESEVE PËRPUNUESE DHE ATYRE TË GRUMBULLIM-TREGTIMIT

Që tani evidentohet nevoja për ekzistencën e bizneseve përpunuese të produkteve bujqësore

dhe blegtorale si edhe aktiviteteve grumbulluese dhe tregtuese. Këto lloj biznesesh paraqiten si nevojë, pasi shumë produkte mund të përpunohen pranë vendit të prodhimit duke ulur kostot e transportit të cilat janë të larta dhe garantimi i tregut për produktet në mënyrë individuale jo vetëm që është i vështirë por është edhe i kushtueshëm. Këto biznese mund të shërbejnë si nxitëse të prodhimit nga fermerët pasi bëhet i mundur garantimi i shitjes së prodhimit dhe planifikimi.

O-Dobësitë reale dhe mënyrat e shmangies së tyre

MOSSHFRYTËZIMI I KAPACITETEVE EKZISTUESE

Dallohet qartë se prodhohet kryesisht për nevoja familjare dhe pak për t'u tregtuar, duke mos shfrytëzuar në mënyrë maksimale kapacitetin prodhues të tokës. Kjo nuk ndodh për arsye se fermerët janë pak të interesuar për fitime apo mungon aftësia e tyre. Ka shkaqe objektive të cilat mund të eliminohen me sigurimin e infrastrukturave normale, mundësimin e kreditimit, mundësimin e organizimeve bashkëkohore dhe garantimin e grumbullimit si edhe tregut të shitjes, që nxit shfrytëzimin maksimal të potencialeve prodhuese dhe përpunuese.

ORGANIZIM DHE INICIATIVA TË PAMJAFTUESHME

Vështirësive objektive i shtohet edhe dobësia e shfaqur në organizimin e përpjekjeve të përbashkëta duke shfrytëzuar kapacitetet intelektuale që nuk mungojnë. Kjo vërtetohet edhe me faktin se në mënyrë sporadike, individë me iniciativë të lartë dhe aftësi organizimi të biznesit, kanë arritur progres jo të vogël. Kërkohej organizim përpjekjesh dhe bashkëpunim, i nxitur dhe përkrahur nga qeverisja vendore dhe ajo qendrore, që të ndërmerren iniciativa të përbashkëta, të cilat deri tani nuk janë të mjaftueshme për të folur për zhvillim ekonomik të konsiderueshëm.

BASHKËRENDIMI I PËRPJEKJEVE

Nuk ekziston klima e përshtatshme e bashkëpunimit për të planifikuar veprime të përbashkëta dhe të ndërvarura. Ndoshta nevojitet ndihmë për të kryer studime konkrete, të cilat do ta bënin më të prekshëm rezultatin përfundimtar të bashkëpunimit. Është detyrë e administratës vendore dhe intelektualëve më të përgatitur që të ndërmarrin propozime dhe të zhvillojnë studime për të paraprirë bashkërendimin e përpjekjeve bazuar në platforma të qarta bashkëpunimi.

PRODHOHET KRYESISHT PËR NEVOJA VETIAKE

Për sa kohë do të vazhdojë gjendja që familjet të prodhojnë vetëm për nevoja vetiake, nuk mund të flasim për biznes prodhues me drejtim bujqësor dhe blegtoral. Sasitë e vogla që tregtojnë familjet janë një shpresë e vogël në drejtim të zhvillimit ekonomik të zonës. Kërkohej që me iniciativa të komunës të nxitet fillimisht studimi i mundësive që ka çdo familje për të prodhuar me destinacion tregun dhe më

pas organizimi për planifikimin e prodhimeve vjetore dhe organizimi për sigurimin e tregut. Shoqatat e biznesit në bazë të produkteve janë një mundësi e mirë për të filluar organizimin e përpjekjeve.

INFRASTRUKTURA JO CILËSORE PËR TË PËRBALLUAR KUSHTET

Mangësitë e infrastrukturave dallohen pjesërisht në infrastrukturën ujtitëse dhe kulluese. Infrastruktura rrugore është e dobët dhe konsiderohet si faktori më i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të zonës. Mangësitë në furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike si dhe mundësitë e kushtueshme të komunikimit luajnë rol negativ në zhvillimin ekonomik të zonës. Kërkohej planifikim i përmirësimit hap pas hapi të situatës, bazuar në një plan strategjik ku të gjithë aktorët që veprojnë në komunë duhet të gjejnë vetveten me detyra që kërkojnë impenjim dhe bashkëveprim.

T- Kërcënimet dhe shpjegimi i mënyrës së neutralizimit të tyre

MOSARRITJA E PËRMIRËSIMEVE TË DOMOSDOSHME NË INFRASTRUKTURË

Mospërmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe furnizimit me ujë dhe energji në kohë sa më të shpejtë si edhe mosrealizimi i planeve për ujtitjen dhe kullimin e tokave, të cilësuar si ndër shkaqet kryesore të frenimit të zhvillimit, do të ndikonte në dekurajimin e fermerëve për të ndërmarrë iniciativa për shtimin e prodhimit dhe shndërrimin e aktivitetëve të tyre në biznese të mirëfillta me fitim të garantuar. Duke qenë se këto përmirësime janë shumë të kushtueshme dhe burimi i financimit mbetet kryesisht qeverisja qendrore dhe donacionet e huaja, rrezikohet mosrealizimi në kohë i këtyre investimeve. Qeverisja vendore, gjithsesi duhet të bëjë pjesën e saj të punës në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe lobimin për realizimin e tyre bazuar në Planin Strategjik të Zhvillimit.

MOSANGAZHIMI I BANORËVE PËR SHKAK TË NEGLIZHENCËS NË INICIATIVA TË PËRBASHKËTA

Një kërcënim serioz është edhe mosangazhimi i fermerëve në iniciativa të përbashkëta për shkak të mosbesimit ose të moskuptimit të rëndësishëm të tyre. I del për detyrë qeverisjes vendore të ndërmarrë aksione sensibilizuese dhe trajnuese për të arritur mirëkuptimin e fermerëve dhe ngritjen e nivelit menaxhues e planifikues të tyre. Iniciativa të tilla duhet të jenë pjesë integrale e planeve strategjike afatshkurta. Gjithashtu, sugjerohet kryerja e studimeve të mirëfillta që do të shërbejnë për krijimin e besimit në realizimin e iniciativave të përbashkëta apo individuale që synojnë zhvillimin e bizneseve të tyre.

THELLIMI I EMIGRIMIT TË BANORËVE TË RINJ DHE TË KUALIFIKUAR

Një rrezik tjetër është migrimi dhe emigrimi i banorëve të kualifikuar, të cilët për arsye ekonomike do të zgjedhin largimin nga zhvillimi i pronave të tyre në komunë. Kjo pjesë e popullsisë është shumë

aktive dhe konsiderohet humbje për të gjithë komunitetin. Sugjerohet edhe një herë realizimi i studimeve dhe informimi e trajnimi i banorëve për mundësitë e zhvillimit të bizneseve të tyre me fitim ndoshta disa herë më të madh se të ardhurat që mund të sigurojnë duke migruar apo emigruar.

DEGRADIMI I AMBIENTIT

Kuptohet se duhet marrë në konsideratë edhe kërcënimin e degradimit të tokave bujqësore, pyjeve, kullotave si edhe degradimi i elementeve të zhvillimit të blegtorisë në rast se nuk kushtohet vëmendja e duhur në ruajtjen dhe mbarështimin e tyre. Kjo gjë evidentohet dhe shumë shpejt duhen marrë masa për frenimin e degradimit me tendencë përmirësimin e tyre. Krijimi i klimës së besimit në suksesin e bizneseve vendase do të krijojë kushtet e duhura krahas investimeve të përqëndruara.

MOSANGAZHIMI SA DUHET I QEVERISJES QENDRORE NË PËRMIRËSIMIN E SITUATËS

Një kërcënim që duhet marrë parasysh për t'u eliminuar sa më parë është mosngritja në nivelin e duhur të angazhimit të administratës publike vendore dhe qendrore duke u nisur edhe nga fakti i ruajtjes së gjendjes pezull deri sa të marrë drejtimin e duhur çështja e ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës, liqeni i së cilës përmyt një pjesë të konsiderueshme të sipërfaqeve të disa fshatrave. Studime alternative që parashikojnë skenarë të mundshëm zgjidhjeje janë të domosdoshme për t'u përfshirë në Planet Strategjike, ku edhe shmangia e efekteve sociale me pasoja dëmtoese do të jenë të përfshira.

X. Matrica e Planit Strategjik

Synimi	Fusha	Objektivat	Programet	Nr.	Projektet	
<p>Zall Dardha në 2015 do të jetë një komunë ku garantohet qeverisja dhe infrastruktura cilësore për arritjen e zhvillimit ekonomik e social në nivele të kërkuara nga komuniteti dhe si rezultat i rritjes sasore dhe cilësore të prodhimit bazuar në burimet natyrore të zonës, kryesisht ai blegtoral dhe bujqësor, do të mundësojë sigurimin e tregut dhe të ardhura të larta për komunitetin nëpërmjet bizneseve të suksesshme</p>	Administrata	<p>1.1 Modernizimi i qeverisjes komunare për t'iu përgjigjur cilësisht kërkesave të komunitetit dhe zhvillimit ekonomik në komunë</p>	<p>1.1.1 Ngritje kapacitetesh qeverisëse</p>	1	Mbajtja e financave dhe kontabilitetit në administratën e komunës duke përdorur programin ALFA	
				2	Trajnimi i punonjësve të administratës dhe kështilltarëve	
				3	Instalimi i mjeteve dhe pajisjeve për stafin dhe trajnimi për përdorimin e tyre	
				4	Mbrojtja dhe mirëmbajtja e pasurive pyjore të komunës	
				5	Çertifikimi i pronave publike dhe kryerja e një studimi për mundësitë e menaxhimit të tyre me efikasitet	
				6	Studimi mbi efektet ekonomike dhe sociale që sjell ndërtimi i liqenit të HEC-it të Skavicës	
	<p>Synimi 1: Rritja dhe forcimi i kapaciteve në komunitet për të mundësuar një qeverisje dhe menaxhim cilësor të çështjeve publike dhe të biznesit</p>	Arsimimi dhe zhvillimi profesional	<p>1.2 Ngritja e infrastrukturës për thithjen e njohurive bashkëkohore dhe rritjen e aftësisë të komunitetit për të përballuar kërkesat e zhvillimit ekonomik në Zall Dardhë</p>	<p>1.2.1 Ngritje e infrastrukturës fizike të arsimit</p>	7	Ndërtimi i shkollës fillore Tartaj
					8	Ndërtimi i shkollës fillore në Merskanë dhe Lashkizë
					9	Rikonstruksioni i shkollës Lashkizë
					10	Rikonstruksioni i katit të tretë të shkollës së mesme
					11	Ndërtimi i Qendrës Kulturore Zall Dardhë
		12	Organizimi i kursit të kualifikimit për blegtorët			
		13	Ngritja pranë komunës e Njesisë së Zhvillimit Profesional			
		14	Organizimi i kursit të kualifikimit për fermerët me drejtim bujqësinë dhe frutikuturën			
		15	Organizimi i kursit të kualifikimit për bletërritësit dhe kutivuesit e bimëve medicinale			
		16	Realizimi i bibliotekës letrare dhe shkencore pranë shkollës së mesme			
		17	Studimi për organizimin e arsimit parashkollor			

Synimi	Fusha	Objektivat	Programet	Nr.	Projektet
<p>Nëpërmjet këtij projekti do të realizohet trajnimi i personelit të shërbimit parësor shëndetësor në mënyrë që t'u përgjigjen kërkesave të kohës.</p> <p>Për realizimin e tij do të ndiqen hapat e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Evidentimi i nevojave për trajnim në bashkëpunim me institucionet e shërbimit shëndetësor 2. Evidentimi i mundësive të institucioneve të shërbimit shëndetësor për të mundësuar trajnimin sipas tematikave të evidentuara më parë 3. Analizimi i mundësive financiare për sigurimin e trajnimeve të domosdoshme që nuk mund të sigurohen nga institucionet partnere 4. Ndërtimi i grafikut të trajnimeve sipas tematikave dhe planifikimi i pjesëmarrjes 5. Realizimi i trajnimeve dhe arshivimi i materialeve të përdorura gjatë trajnimeve së bashku me raportin përkatës dhe propozime të mundshme <p>Gjatë studimit të nevojave do të merret parasysh edhe perspektiva e zhvillimeve të mundshme në komunë për t'i paraprirë nevojave afatshkurta</p>		
Rezultatet e pritshme:		Përfutjesit:
<p>Ngritja e nivelit të punonjësve të shërbimit shëndetësor parësor</p> <p>Arritja e standarteve bashkëkohore të shërbimit shëndetësor</p> <p>Rritja e nivelit të kënaqshmërisë së komunitetit për shërbimet e ofruara</p>		<p>Personeli i shërbimit shëndetësor parësor në komunë</p> <p>Komuniteti</p>
Pjesëmarrësit potencialë:		Kontributet potenciale në projekt:
<p>Drejtuessit e Qendrës Shëndetësore në komunë</p> <p>Institucionet e shërbimit shëndetësor</p>		<p>Institucionet e shërbimit shëndetësor</p> <p>Drejtuessit e Qendrës Shëndetësore në komunë</p> <p>Donatorë të specializuar të fushës</p>
Kushte paraprake:		Faktorë të rrezikshëm:
<p>Studimi i nevojave dhe mundësi</p> <p>Miratimi i fondeve të mjaftueshme</p> <p>Ndërtimi i grafikut të zhvillimit të trajnimeve</p>		<p>Mosigurimi i mundësisë për zhvillimin e trajnimeve</p> <p>Neglizhenca e punonjësve të shërbimit shëndetësor</p>
Shpenzimet e llogaritura:		
<p>Për dieta, akomodim dhe transport</p> <p>Për pjesëmarrje në trajnim</p>		<p>() Lekë</p> <p>() Lekë</p> <p>TOTALI:</p>
Koha e zbatimit:	2008-2010	Periudha e pritjes së rezultatit:
		Pas çdo trajnimi

Emërtimi i projektit	Kodi Q2.O2.P2.Pr.28	Emërtimi i objektivit:
Projektimi dhe ndërtimi i lidhjes telefonike kablore me rrjetin kombëtar dhe realizimi i shërbimit postar		Garantimi i një infrastrukture komunikimi cilësore për banorët dhe që mundëson cilësi jetese dhe arsimimi të mirë
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
Me anë të këtij projekti do të bëhet e mundur lidhja e komunës me rrjetin kombëtar të telefonisë fikse. Projekti do të ndërtohet në disa faza, ku përveç lidhjes kablore me rrjetin kombëtar do të parashikohet një çentral me kapacitet të mjaftueshëm për abonentët e mundshëm në çdo fshat, rrjetin përkatës, si edhe parashikohet hapja e shërbimit postar në bashkëpunim me Drejtorinë e Postave. Konkretisht:		
Faza e projektim-studimit:		
1. Projektimi dhe preventivimi i punëve të ndërtimit për shtrimin e linjës kablore, godinës së çentralit, rrjetit të shpërndarjes dhe godinës së Postës		
2. Studimi, projektimi dhe përgatitja e preventivit për pajisjet e çentralit telefonik, rrjetin telefonik dhe pajisjet e Zyrës Postare		
3. Studimi i projekteve dhe preventivave dhe bashkëpunimi me partnerët e mundshëm për të përcaktuar fazat e zbatimit dhe kontributet e pjesëmarrësve në projekt		
Faza e ndërtimit:		
Zhvillimi i procedurave të prokurimit të ndërtim-montimit dhe realizimi i projektit të miratuar në organet kompetente		
Faza e operimit:		
Vënia në punë e rrjetit telefonik dhe shërbimit postar në bazë të akt-marrëveshjes së përgatitur paraprakisht me pjesëmarrësit në projekt		
Rezultatet e pritshme:		Përfutjesit:
Sigurimi i shërbimit telefonik fiks dhe mundësimi i tij për abonentët e komunitetit		Komuniteti
Krijimi i lidhjeve normale ndërinstucionale		Drejtoria Arsimore dhe ajo e shkolllës
Mundësimi i ofrimit të shërbimeve të shumta që ofron shërbimi postar për komunitetin		Komuna
Mundësimi i përdorimit të internetit duke e konsideruar si nevojë të kohës		
Pjesëmarrësit potencialë:		Kontributet potenciale në projekt:
Autoritetet e Komunës		Komuna
Drejtoria e Përgjithshme e Postave		Donatorë të mundshëm vendas dhe të huaj
Ministria e P.P.Transportit e Telekomunikacionit		Institucione të qeverisjes qendrore
Kushte paraprake:		Faktorë të rrezikshëm:
Përgatitja e projekteve, preventivave dhe studimit		Mosigurimi i fondeve të mjaftueshme
Miratimi i fondeve të mjaftueshme në bazë të akt-marrëveshjeve me partnerët e projektit		Mosarritja e marrëveshjes me aktorët kryesorë
Sigurimi i lejeve përkatëse për realizimin e projektit		Menaxhimi dhe koordinimi i dobët me pjesëmarrësit në projekt
Shpenzimet e llogaritura:		
Për fazën e projektim-studimit	() Lekë	
Për fazën e ndërtim-montimit	() Lekë	
Për fazën e vënies në punë dhe operimit (për një vit)	() Lekë	
TOTALI:		
Koha e zbatimit:	2008-2010	Perioda e pritjes së rezultatit:
		2010

KOMUNA ZALLDARDHË, QARKU DIBËR

Emërtimi i projektit	Kodi Q2.O3.P1.Pr.34	Emërtimi i objektivit:
Ndërtimi i rrugës për në lagjen (Dervishej) Xhoxhaj Lugjej		Zhvillimi i infrastrukturës rrugore në komunën e Zall Dardhës në standarde që i kërkon komuniteti dhe biznesi
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
Projekti presupozon projektimin dhe ndërtimin e rrugës që lidh lagjen Xhoxhaj me qendrën e komunës Zall Dardhë. Kjo rrugë konsiderohet tepër e nevojshme. Kjo rrugë ka këto të dhëna të përafërta: Gjatësia 15 km ; Gjerësia 5 m ; Kanale Gjatësore 1400 m ; Kanale Tërthore 42 m ; Vepra Arti Ura 1 copë (gjithsej 4 m) ; Prita 10 m Bazamenti i rrugës është tokë e fortë 90% dhe shkëmb i butë 10% Duhet të zhvendosen afërsisht 280 m ³ shkëmb		
Rezultatet e pritshme:		Përfutjesit:
Komunikimi më i shpejtë dhe i sigurtë me qendrën e komunës Nxitja dhe lehtësimi i aktiviteteve ekonomike Mundësimi i ofrimit të shërbimeve në qendër të komunës Transport më i shpejtë dhe më pak i kushtueshëm për nxënësit e shkollave		Komuniteti i fshatrave Komuniteti i biznesit Administrata e Komunës
Pjesëmarrësit potencialë:		Kontributet potenciale në projekt:
Autoritetet e Komunës Qarku i Dibrës Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve Ministria e P.P.Transportit e Telekomunikacionit		Komuna Qarku i Dibrës Donatorë të mundshëm vendas dhe të huaj Institucione të qeverisjes qendrore
Kushte paraprake:		Faktorë të rrezikshëm:
Përgatitja e projekteve, preventivave dhe studimit Miratimi i fondeve të mjaftueshme në bazë të akt-marrëveshjeve me partnerët e projektit Sigurimi i lejeve përkatëse për realizimin e projektit		Mosigurimi i fondeve të mjaftueshme Mosarritja e marrëveshjes me institucionet bashkëpunuese Menaxhimi dhe koordinimi i dobët me pjesëmarrësit në projekt
Shpenzimet e llogaritura:		
Për fazën e projektim-studimit Për fazën e ndërtimit		(200,000) Lekë (5,000,000) Lekë TOTALI: 5,200,000 Lekë
Koha e zbatimit:	2008-2010	Periudha e pritjes së rezultatit:
		2010

Emërtimi i projektit	Kodi Q2.03.P1.Pr.36	Emërtimi i objektivit:
Ndërtimi i rrugës Lashkizë-Tartaj-Mënesh		Zhvillimi i infrastrukturës rrugore në komunën e Zall Dardhës në standarte që i kërkon komuniteti dhe biznesi
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
<p>Projekti presupozon projektimin dhe ndërtimin e rrugës që lidh tre fshatra me qendrën e komunës Zall Dardhë. Kjo rrugë konsiderohet tepër e nevojshme pasi realizohet lidhja e tre fshatrave</p> <p>Kjo rrugë ka këto të dhëna të përafërta:</p> <p>Gjatësia 5 km ; Gjerësia 5 m ; Kanale Gjatësore 400 m ; Kanale Tërthore 150 m ; Vepra Arti Ura 2 copë (gjithsej 8 m) ; Prita 50 m</p> <p>Bazamenti i rrugës është shkëmb 60% dhe tokë e fortë 40%</p> <p>Duhet të zhvendosen afërsisht 9 000 m³ shkëmb.</p>		
Rezultatet e pritshme:		Përfituesit:
Komunikimi më i shpejtë dhe i sigurtë me qendrën e komunës		Komuniteti i fshatrave
Nxitiqja dhe lehtësimi i aktiviteteve ekonomike		Komuniteti i biznesit
Mundësimi i ofrimit të shërbimeve në qendër të komunës		Administrata e Komunës
Transporti më i shpejtë dhe më pak i kushtueshëm për nxënësit e shkollave		
Pjesëmarrësit potencialë:		Kontributet potenciale në projekt:
Autoritetet e Komunës		Komuna
Qarku i Dibrës		Qarku i Dibrës
Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve		Donatorë të mundshëm vendas dhe të huaj
Ministria e P.P.Transportit e Telekomunikacionit		Institucione të qeverisjes qendrore
Kushte paraprake:		Faktorë të rrezikshëm:
Përgatitja e projekteve, preventivave dhe studimit		Mosigurimi i fondeve të mjaftueshme
Miratimi i fondeve të mjaftueshme në bazë të akt-marrëveshjeve me partnerët e projektit		Mosarritja e marrëveshjes me institucionet bashkëpunuese
Sigurimi i lejeve përkatëse për realizimin e projektit		Menaxhimi dhe koordinimi i dobët me pjesëmarrësit në projekt
Shpenzimet e llogaritura:		
Për fazën e projektim-studimit		(300,000) Lekë
Për fazën e ndërtimit		(1,200,000) Lekë
		TOTALI: 1,500,000 Lekë
Koha e zbatimit:	2008-2010	Periudha e pritjes së rezultatit:
		2010

Emërtimi i projektit	Kodi Q2.O3.P1.Pr.39	Emërtimi i objektivit:
Ndërtimi i rrugës Përroi i Brokës-Nezhaj-Mustafe		Zhvillimi i infrastrukturës rrugore në komunën e Zall Dardhës në standarte që i kërkon komuniteti dhe biznesi
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
Projekti presupozon projektimin dhe ndërtimin e rrugës që lidh fshatin Nezhaj me qendrën e Zall Dardhës. Kjo rrugë konsiderohet tepër e nevojshme pasi realizohet lidhja me komunën fqinje të Arrasit nëpërmjet fshatit Mustafe.		
Kjo rrugë ka këto të dhëna të përafërta: Gjatësia 5 km ; Gjerësia 5 m ; Kanale Tërthore 4 300 m ; Kanale Tërthore 120 m ; Vepra Arti Ura 1 copë (gjithsej 4 m) ; Prita 20 m Bazamenti i rrugës është tokë e fortë 90% dhe shkëmb i butë 10% Duhet të zhvendosen afërsisht 800 m ³ shkëmb		
Rezultatet e pritshme:		Përfutjesit:
Komunikimi më i shpejtë dhe i sigurtë me qendrën e komunës Nxitja dhe lehtësimi i aktiviteteve ekonomike Mundësimi i ofrimit të shërbimeve në qendër të komunës Transporti më i shpejtë dhe më pak i kushtueshëm për nxënësit e shkollave		Komuniteti i fshatrave Komuniteti i biznesit Administrata e Komunës
Pjesëmarrësit potencialë:		Kontributet potenciale në projekt:
Autoritetet e Komunës Qarku i Dibrës Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve Ministria e P.P.Transportit e Telekomunikacionit		Komuna Qarku i Dibrës Donatorë të mundshëm vendas dhe të huaj Institucione të qeverisjes qendrore
Kushte paraprake:		Faktorë të rrezikshëm:
Përgatitja e projekteve, preventivave dhe studimit Miratimi i fondeve të mjaftueshme në bazë të akt-marrëveshjeve me partnerët e projektit Sigurimi i lejeve përkatëse për realizimin e projektit		Mosigurimi i fondeve të mjaftueshme Mosarritja e marrëveshjes me institucionet bashkëpunuese Menaxhimi dhe koordinimi i dobët me pjesëmarrësit në projekt
Shpenzimet e llogaritura:		
Për fazën e projektim-studimit Për fazën e ndërtimit		(460,000) Lekë (10,000,000) Lekë TOTALI: 10,460,000 Lekë
Koha e zbatimit:	2008-2010	Periudha e pritjes së rezultatit:
		2010

Emërtimi i projektit	Kodi Q2.O4.P1.Pr.48	Emërtimi i objektivit:
Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Lashkizë		Sigurimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe energji elektrike në të gjithë komunën
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
<p>Projekti presupozon projektimin dhe ndërtimin e ujësjellësit në lagjen Merskan të fshatit Lashkizë, i cili do të shërbejë për furnizimin me ujë të pijshëm të fshatit Zall Dardhë. Do të shfrytëzohet burimi Ujë e Lashkizës, i cili llogaritet të ketë një prurje mesatare _____m³/sek. Ujësllësi do të jetë i tipit me vetërrjedhje. Do të ketë 1 depozitë dhe mendohet të ketë kapacitet 50 m³.</p> <p>Për ndërtimin e këtij ujësjellësi do të ndiqen hapat e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Studimi i mundësive dhe i kapaciteteve të veprës së marrjes dhe rrjetit të shpërndarjes 2. Realizimi i projektit të plotë teknik dhe përgatitja e preventivit si për anën ndërtimore ashtu edhe të makinerive dhe pajisjeve 3. Studimi i mundësive të financ. të këtij projekti me aktorë të tjerë të mundshëm, si institucionet e qeverisjes qendrore, qarkut apo donatorë të ndryshëm 4. Nënshkrimi i marrëveshjes së autoriteteve të komunës me pjesëmarrësit e tjerë të evidentuar si pjesëmarrës në projekt 5. Miratimi i lejeve përkatëse për ndërtimin e kësaj vepre 6. Zhvillimi i procedurave ligjore të prokurimit për zbatimin e projektit 7. Përcaktimi i formës dhe strukt. organizative për menaxhimin e kësaj vepre 		
Rezultatet e pritshme:		
Furnizimi me ujë i një komuniteti prej _____ banorësh		
Lehtësimi i aktiviteteve ekonomike ekzistuese dhe të perspektivës		
Rritja e kënaqshmërisë dhe e besimit të banorëve për organet qeverisëse		
Pjesëmarrësit potencialë:		
Autoritetet e Komunës		
Qarku i Dibrës		
Donatorë të mundshëm vendas dhe të huaj		
Ministria e P.P.Transportit e Telekomunikacionit		
Kushte paraprake:		
Përgatitja e projekteve, preventivave dhe studimit		
Miratimi i fondeve të mjaftueshme në bazë të akt-marrëveshjeve me partnerët e projektit		
Sigurimi i lejeve përkatëse për realizimin e projektit		
Shpenzimet e logaritura:		
Për fazën e projektimit-studimit		
Për fazën e ndërtimit		
(240,000) Lekë		
(11,528,992) Lekë		
TOTALI: 11,768,992 Lekë		
Koha e zbatimit:	2008-2010	Periudha e pritjes së rezultatit:
		2010

<p>Emërtimi i projektit</p> <p>Ndërtimi i kanaleve vaditëse të tokave të fshatit Zall Dardhë</p>	<p>Kodi Q3.O1.P2.Pr.62</p> <p>Emërtimi i objektit:</p> <p>Rritja e prodhimit bujqësor në përputhje me nevojat në rritje të blegtorisë, atij të drurëve frutorë tradicionalë si edhe të bimëve medicinale duke synuar tregtimin e përqëndruar dhe të garantuar</p>
<p>Përshkrim i shkurtër i projektit:</p> <p>Me anë të realizimit të këtij projekti do të mundësohet vadija e tokave që nuk janë nën ujë në fshatin Zall Dardhë, duke rritur mundësinë e prodhimeve bujqësore. Uji do të merret nga përroi i Lashkizës dhe Setës. Gjatësia e kanaleve kryesore është afërsisht 6.8 km. Gjatësia e kanaleve dytësore është afërsisht gjithsej 0 km. Sipërfaqja e vënë nën ujë nëpërmjet këtij sistemi vaditës është afërsisht 400 ha. Për realizimin e këtij projekti do të ndiqen hapat e mëposhtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e studimit për mundësitë dhe nevojat e sipërfaqes së planifikuar për t'u vënë nën ujë 2. Studimi i mundësive të financimit të këtij projekti 3. Përgatitja e projektit teknik të gatshëm për t'u miratuar nga organet kompetente 4. Zyrtarizimi i akt-marrëveshjeve të mundshme me pjesëmarrësit në projekt 5. Miratimi i lejes për zbatimin e projektit 6. Zhvillimi i procedurave ligjore të prokurimit për zbatimin e projektit 7. Zyrtarizimi i mënyrës së menaxhimit dhe mirëmbajtjes së sistemit vaditës 	
<p>Rezultatet e pritshme:</p> <p>Vënia nën ujë e sipërfaqes së planifikuar</p> <p>Rritja e prodhimit të marrë nga tokat e vëna nën ujë në sasi dhe llojshmëri</p> <p>Rritja e ekonomisë së fermerëve që përfitojnë nga projekti</p> <p>Rritja e besimit dhe kënaqshmërisë së komunitetit krahas rritjes ekonomike</p>	<p>Përfutuesit:</p> <p>Komuniteti i fshatit</p> <p>Komuniteti i biznesit</p> <p>Administrata e Komunës</p>
<p>Pjesëmarrësit potencialë:</p> <p>Autoritetet e Komunës</p> <p>Qarku i Dibrës</p> <p>Investitorë të mundshëm</p> <p>Drejtoria Rajonale e Bujqësisë</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit</p>	<p>Kontributet potenciale në projekt:</p> <p>Komuna</p> <p>Qarku i Dibrës</p> <p>Donatorë të mundshëm vendas dhe të huaj</p> <p>Institucione të qeverisjes qendrore</p>
<p>Kushte paraprake:</p> <p>Përgatitja e projekteve, preventivave dhe studimit</p> <p>Miratimi i fondeve të mjaftueshme në bazë të akt-marrëveshjeve me partnerët e projektit</p> <p>Sigurimi i lejeve përkatëse për realizimin e projektit</p>	<p>Faktorë të rrezikshëm:</p> <p>Mosigurimi i fondeve të mjaftueshme</p> <p>Mosarritja e marrëveshjes me institucionet bashkëpunuese</p> <p>Koordinimi i dobët me pjesëmarrësit në projekt</p>
<p>Shpenzimet e llogaritura:</p> <p>Për fazën e projektimit-studimit</p> <p>Për fazën e ndërtimit</p>	<p>(680,000) Lekë</p> <p>(13,600,000) Lekë</p> <p>TOTALI:14,280,000 Lekë</p>
<p>Koha e zbatimit:</p> <p>2008-2010</p>	<p>Periudha e pritjes së rezultatit:</p> <p>2010</p>

Emërtimi i projektit Kodi Q3.O3.P1.Pr.75 Ndërtimi i një baxhoje për përpunimin e produkteve blegtorale Lashkizë	Emërtimi i objektivit: Shtimi i numrit të bizneseve të vogla përpunuese të prodhimeve, me bazë burimet e komunës, duke mundësuar shtimin e volumit të këtyre produkteve për treg
Përshkrim i shkurtër i projektit: Ky projekt synon realizimin e një njësie për përpunimin e produkteve blegtorale në fshatin Lashkizë. Ekzistojnë tre alternative të mundshme me disa variante, pra, ose do të jetë pronë dhe aktivitet privat ose do të jetë pronë e komunës dhe menaxhim i komunës ose do të jetë pronë e komunës dhe menaxhim nga subjekt privat. Cilado qoftë forma e realizimit është e pa diskutueshme nevoja që të përgatitet një projekt ndërtimor dhe teknologjik që i përgjigjet nevojave të blegtorëve të zonës. Projekti planifikohet të ndahet në disa faza, të cilat po i rendisim më poshtë: Faza e studimit dhe projektimit: 1. Ngritja e një grupi pune për studimin e alternativave të mundshme përsa i përket pronësisë dhe formës së menaxhimit bazuar në kapacitetin e llogarit; 2. Përgatitja e projektit teknik ndërtimor dhe teknologjik shoqëruar me preventivat përkatës; 3. Studimi i mundësive të financimit sipas alternativave të identifikuara; 4. Përcaktimi përfundimtar i mënyrës dhe formës së realizimit të projektit Faza e ndërtimit: 1. Miratimi i lejeve përkatëse nga organet kompetente; 2. Zhvillimi i procedurave të prokurimit të ndërtim-montimit dhe realizimi i projektit të miratuar në organet kompetente Faza e operimit: 1. Vënia në punë në bazë të akt-marrëveshjeve të përgatitura paraprakisht me pjesëmarrësit në projekt	
Rezultatet e pritshme: Sigurimi i shërbimit të përpunimit të përqëndruar të produkteve blegtorale Rritja e prodhimeve blegtorale si rezultat i sigurimit të tregut Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet fermerëve me drejtim blegtoral Rritja e mundësisë për treg të garantuar	Përfutjesit: Komuniteti i fermerëve me drejtim blegtoral Komuniteti i biznesit Komuna
Pjesëmarrësit potencialë: Autoritetet e Komunës Fermerët me drejtim blegtoral Institucionet qendrore dhe vendore të interesuara	Kontributet potenciale në projekt: Komuna Donatorë të mundshëm vendas dhe të huaj Fermerë dhe investitorë privatë të interesuar Institucione të qeverisjes qendrore dhe vendore
Kushte paraprake: Përgatitja e studimit të alternativave, projekteve dhe preventivave Sigurimi i fondeve të mjaftueshme në bazë të akt-marrëveshjeve me partnerët e projektit Sigurimi i lejeve përkatëse për realizimin e projektit	Faktorë të rrezikshëm: Mossigurimi i fondeve të mjaftueshme Mosarritja e marrëveshjes me aktorët kryesorë Menaxhimi dhe koordinimi i dobët me pjesëmarrësit në projekt
Shpenzimet e llogaritura: Për fazën e projektim-studimit Për fazën e ndërtim-montimit Për fazën e vënies në punë dhe operimit (për një vit)) Lekë) Lekë) Lekë TOTALI:
Koha e zbatimit: 2008-2010	Periudha e pritjes së rezultatit: 2011

Emërtimi i projektit Kryerja e studimit për mundësinë e kultivimit, përpunimit dhe distilimit të sherbelës për eksport	Emërtimi i objektivit: Shtimi i numrit të bizneseve të vogla përpunuese të prodhimeve, me bazë burime të komunës, duke mundësuar shtimin e volumit të këtyre produkteve për treg
Përshkrim i shkurtër i projektit: Npërmjet këtij projekti synohet që të studiohet situata lidhur me mundësinë e rritjes së shfrytëzimit të sherbelës nga ana e komunitetit të komunës. Faktikisht, realizohet mbledhje dhe shitje sporadike e sherbelës por ky aktivitet rezulton se mund të planifikohet dhe shumëfishohet nga pikëpamja sasore por edhe mund të gjenden mundësi për kultivimin, grumbullimin dhe përpunimin në vend. Projekti synon t'i studiojë këto mundësi dhe të përgatisë një udhëzues për mënyrën e realizimit dhe zhvillimit të veprimitarive ekonomike që lidhen me sherbelën. Ky studim mendohet të jetë edhe si shembull për studimin e mundësive të tjera që janë evidentuar të mundshme në fushën e bimëve medicinale. Për realizimin e këtij projekti do të ndiqen hapat e mëposhtëm: 1. Gjetja e mundësisë për financimin e këtij studimi që do të përmbajë aktivitetet e mëposhtme: a) Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave ekzistuese statistikore, shkencore dhe të marketingut nëpërmjet ngritjes së një grupi pune; b) Përgatitja e studimit bazuar në të dhënat e grumbulluara duke përfshirë edhe një udhëzues praktik lehtësisht të kuptueshëm për fermerët; c) Botimi, promovimi dhe shpërndarja e broshurës tek të interesuarit 2. Identifikimi i të interesuarve dhe planifikimi i veprimeve të mëtejshme me terma konkretë që parashikojnë kontributet e të gjithë aktorëve 3. Miratimi në Këshillin e Komunës të masave nxitëse dhe lehtësuese për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në fushën e bimëve medicinale	
Rezultatet e pritshme: Rritja në sasi e mbledhjes së sherbelës Nxitja për lindjen e aktiviteteve të mirëfillta ekonomike që lidhen me sherbelën Rritja e ekonomisë së fermerëve që përfitojnë nga projekti Rritja e besimit dhe kënaqshmërisë së komunitetit krahas rritjes ekonomike	
Pjesëmarrësit potencialë: Autoritetet e Komunës Qarku i Dibrës Donatorë të mundshëm Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit	
Kushte paraprake: Sigurimi i fondeve të mjaftueshme për kryerjen e studimit me të gjithë komponentët Gjetja dhe angazhimi i specialistëve të mirëfilltë për kryerjen e studimit Sigurimi i bashkëpunimit me institucionet që mund të ndihmojnë në projekt	
Shpenzimet e llogaritura: Për fazën e grumbullimit të të dhënave Për fazën e kryerjes së studimit Për fazën e botimit dhe promovimit	
Koha e zbatimit: 2008-2009	
TOTALI: Periudha e pritjes së rezultatit: 2009	

Emërtimi i projektit	Kodi Q3.O3.P3.Pr.60,70,82	Emërtimi i objektivit: edhe Q3
60. Ngritja e Shoqatës së Fermerëve me drejtim Bujqësor 70. Ngritja e Shoqatës së Fermerëve me drejtim Blegtoral 82. Ngritja e Shoqatës së Bimëve Mjekësore		Shtimi i numrit të bizneseve të vogla përpunuese të prodhimeve, me bazë burimet e komunës, duke mundësuar shtimin e volumit të këtyre produkteve për treg
Përshkrim i shkurtër i projektit:		
Ky projekt do të mundësojë insitucionalizimin e bashkëpunimit të fermerëve me interesa të përbashkëta. Për realizimin e tij do të ndiqen hapat e mëposhtëm:		
<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja nga ana e Komunës, në bashkëpunim me specialistë të fushës, e një materiali informues lidhur me avantazhet që kanë krijimet e shoqatave apo grupimeve të fermerëve që kanë interesa të përbashkëta si edhe mënyrën e insitucionalizimit të tyre për t'u bërë faktor aktiv në jetën ekonomiko-sociale të komunës e më gjerë 2. Shpërndarja e informacionit dhe organizimi i mbledhjeve publike me të interesuarit për t'u shpjeguar edhe format e ndihmës që do të sigurojë komuna në drejtim të sigurimit të ambienteve për zhvillimin e mbledhjeve periodike etj. si edhe sigurimin që zëri i tyre i përbashkët do të merret parasysh në vendimet e autoriteteve vendore 3. Asistimi në ngritjen dhe legalizimin e këtyre shoqatave me bazë vullnetin e lirë dhe interesin e përbashkët duke i ndihmuar në përgatitjen e statutit dhe formën organizative të funksionimit 4. Miratimi në Këshillin e Komunës të një fondi për mbështetjen e këtyre shoqatave në fazat e para të veprimtarisë së tyre duke i konsideruar partnerë të ardhshëm 		
Rezultatet e pritshme:		Përfituesit:
Ngritja e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet fermerëve me interesa të përbashkëta Sigurimi i premisave për rritjen e pjesëmarrjes së komunitetit në vendimmarrje Ngritja e ekonomisë së bizneseve të fushës Sigurimi i partnerëve të domosdoshëm për qeverisjen vendore		Administrata e Komunës Komuniteti i biznesit me interesa të përbashkëta
Pjesëmarrësit potencialë:		Kontributet potenciale në projekt:
Autoritetet e Komunës dhe punonjësit e administratës Fermerët me interesa të përbashkëta ShKSh, Qarku, SNV etj		Komuna Donatorë të mundshëm vendas dhe të huaj Komuniteti i biznesit
Kushte paraprake:		Faktorë të rrezikshëm:
Përgatitja e materialeve informuese Përzgjedhja e individëve të besueshëm dhe të aftë nga pikëpamja organizative për ndihmë Informimi me të gjitha mjetet e mundshme të komunitetit		Mosrealizimi i informimit të mjaftueshëm për fermerët Neglizhenca e punonjësve të administratës vendore dhe fermerëve Moskrijimi i nivelit të besueshmërisë për rezultatet e pritshme
Shpenzimet e llogaritura:		
Për materiale informuese Për organizimin e takimeve Për përgatitjen dhe legalizimin e dokumenteve		() Lekë () Lekë () Lekë
Koha e zbatimit:	2008-2009	Periudha e pritjes së rezultatit: 2009
		TOTALI:

Shtojca 1: Vendimi i Këshillit Komunal për miratimin e PSZh**REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMUNA ZALL DARDHE
(KESHILLI I KOMUNES)**Nr. 2 prot.

Zall Dardhe me 24.01.2008

VENDIM**Nr 01 date 24.01.2008****“Per miratimin e Planit Strategjik te Zhvillimit te komunes”**


Keshilli I komunes Zall Dardhe I mbledhur sote me date 24.01.2008 mbeshtetur ne ligjin Nr.8652 date 31.07.2000.” Per organizimijn dhe funksionimin e qeverisjes Vendore” mori ne shqyrtim draftin e Hartimit te Strategjise Afat Mesme 2008-2015 te Komunes Zall Dardhe te pregaditur nga grupi I punes dhe me nje pjesmarrje te gjere te komunitetit ne hartimin e ketij drafti Keshilli I komunes me vote unanime

VENDOSI:

1. Te miratoje Hartimin e Strategjise Afatmesme 2008-2015 te Komunes Zall Dardhe.
- 2-Te perkthehet dhe te kaloje per shtypshkrim.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT TE KOMUNES

Hekuran POLESHI



Shtojca 2: Analiza e sondazhit me biznesin vendor

Raport për sipërmarrjen vendore që jep mundësi për vëzhgimin e mjedisit

Gjatë tetorit 2007, në tre komuna të qarkut të Dibrës u krye një anketim për sjelljen e biznesit. Synimi i anketimit është t'i japë Komisionit të Planit Strategjik të komunave Arras, Zall Dardhë dhe Fushë Çidhën të dhëna në lidhje me nevojat dhe këndvështrimet e biznesit për zhvillimin e tyre të ardhshëm dhe për ndihmë në drejtimin e energjive, përpjekjeve dhe fondeve drejt rritjes së zhvillimit ekonomik vendor të këtyre zonave mjaft të varfra fshatare të Shqipërisë.

Pyetësi që u plotësua nga të anketuarit në tre fshatrat, mbështetet tek ai që u përdor në vitin 2003 për projektin DELTA (Zhvillimi i Ekonomive Lokalisht përmes Teknikave dhe Aleancave) në pesë qytete (Berat, Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër) të Shqipërisë, me ca modifikime të vogla.

Ky vëzhgim u ndërmor në bashkëpunim të ngushtë me kreun dhe stafin e çdo komune dhe me stafin e Këshillit të Qarkut Dibër. Zoti Erind Kraja kreu vëzhgimin që u analizua më pas nga Dr. Iain Wilson.

Analizë e vëzhgimit të biznesit

Të dhëna të përgjithshme

Modele (P. 1)

U anketuan njëzet e tre biznese dhe u mblodhën opinione nga të intervistuarit që vijojnë: pronar, shtatëmbëdhjetë biznese (74%), administrator i përgjithshëm, dy biznese (9%) dhe bujq në katër biznese (17%).

Lloji i biznesit (P. 2)

Thuajse të gjitha bizneset (91%) ishin bujq. Vetëm gjashtë mbillnin drithë, pesë rrisnin bagëti, gjashtë merreshin me të dyja llojet, një mbillte drithë dhe tregtonte, dy ishin thjesht tregtarë dhe dy ofronin shërbime. Kësisoj, më shumë se gjysma e sipërmarrjeve prodhonin prodhime shtazore dhe më shumë se gjysma prodhonin produkte bujqësore joshtazore.

Pronësia (P. 3)

Shtatëmbëdhjetë (74%) sipërmarrje kishin një pronar, ndërkohë që katër punonin tokën por pretendonin se nuk e zotëronin biznesin, ndërsa dy nuk u përgjigjeshin pyetjeve.

Lloji i prodhimit (P. 4)

Shtatë bujq pohuan se prodhonin mish dhe qumësht, ndërsa dy bagëti. Dy u përgjigjën për bujqësi,

shtatë për drithë, ushqim të thatë për bagëti ose perime, ose një gërshetim i tyre, një prodhonte misër, dy fasule dhe një rrush. Tri specifikuan tregti, një nuk iu përgjigj kësaj pyetjeje dhe një u përgjigj ‘bujqësi dhe blegtori për konsum vetiak’.

Kohëzgjatja në veprim (P. 5)

Kohëzgjatja, gjatë së cilës sipërmarrjet kanë vepruar, varionte nga tre në shtatëmbëdhjetë vjet, me një mesatare prej dhjetë vjetësh.

Vendi i tregtimit (P. 6)

44% e sipërmarrjeve e shisnin 100% të prodhimit të tyre në vend, ndërsa të tjerë kishin një tregues që varionte nga 20% në 50%. Tri sipërmarrje të tjera i shisnin prodhimet e tyre në rajon, duke arritur një total prej 54% të këtij grupi. Pesë biznese shisnin diku mes 30 dhe 50% të prodhimit të tyre gjetiu nëpër vend por jo për eksport.

Numri i të punësuarve (P. 7)

Të gjitha bizneset, përveç dy që nuk iu përgjigjën pyetjes, kishin pesë a më pak punëtorë dhe në fakt, shumica kishin vetëm një të punësuar.

Pamje të mjedisit të sipërmarrjes

Zgjerimi i veprimtarisë (P. 8)

Nëntë sipërmarrje raportuan se do ta zgjeronin veprimtarinë e tyre brenda komunës, një jashtë kufijve të komunës, dy raportuan thjesht se do t’a zgjeronin, ndërsa njëmbëdhjetë (48%) pohuan se nuk kishin në plan të zgjeronin veprimtarinë e tyre. Askush nuk kishte në plan të eksportonte prodhimet e veta jashtë vendit.

Vështirësi në gjetjen e stafit të trajnuar (P. 9)

Pothuajse të gjithë (86%) të anketuarit thanë se nuk kishin vështirësi në gjetjen e stafit të kualifikuar.

Fushat e trajnimit të stafit (P. 10)

Pavarësisht nga fakti që shumica e sipërmarrjeve nuk kishin vështirësi në gjetjen e një stafi të trajnuar siç duhet (Q. 9), shumica (74%) mendonin që biznesi i tyre do të përfitonte nga trajnimi në marketing dhe shitje, 26% në administrim (që u rendit i pari nga ata që i përgjigjeshin renditjes), 17% në buxhetim dhe 13% në aftësi të përdorimit të kompjuterit. Dy sipërmarrje dëshironin trajnim në aftësi teknike dhe një u shpreh për frutikulturë.

Burimet kryesore të konkurrencës (P. 11)

Gjashtëmbëdhjetë sipërmarrje (70%) treguan se hasnin njëfarë konkurrence: nga importet (43%, duke përfshirë 9% që specifikonin kontrabandën dhe 9% që specifikonin Maqedoninë), nga bare

apo restorante të tjera (17%), një sipërmarrje iu referua “konkurrencës së pandershme” dhe një u shpreh për ‘financim të vogël’.

Përfitimi i shoqatave të sipërmarrjeve (P. 12)

Shumica e të anketuarve (78%) mendonin që shoqatat e bizneseve mund të ndihmonin në zhvillimin lokal të bizneseve dhe vetëm katër (të gjithë tregtarë) mendonin se nuk mundeshin.

Emërtimi i shoqatave të sipërmarrjes (P. 13)

Nëntë të anketuar (39%) e quanin Natyrore PB si shoqatë biznesi vendor, një përmendi Shoqatën e Ujërave dhe Pyjeve, dy të anketuar thanë që nuk kishte asnjë shoqatë biznesi të pranishme në vend ndërsa, shumica (48%) nuk iu përgjigj pyetjes.

Investime të ardhshme (P. 14)

Pesëmbëdhjetë të anketuar (65%) thanë se do të bënin investime të ardhshme. Nga këta, pesë (33%) specifikuan frutikulturën, katër (27%) shënuan vaditjen, 27% të tjerë specifikuan blegtorinë dhe një u përgjigj bujqësi kurse një tjetër përpunim qumështi. Një bujk tjetër përmendi edhe vreshtat.

Faktorë që pengojnë zgjerimin e biznesit (P. 15)

Të gjithë të anketuarit renditën arsyet që parandalonin zgjerimin e biznesit të tyre. Çështje madhore ishte niveli i varfër i infrastrukturës së rrugës (30%), infrastruktura në përgjithësi (26%) dhe vaditja (22%), të ndjekura nga mungesa e tregtisë dhe e fondeve (secili 9%) dhe konkurrenca me Maqedoninë (4%).

Çështja e dytë madhore ndahej mes mungesës së elektricitetit dhe të mekanikës në bujqësi (26% secili), mungesa e ujit dhe fondeve (13% secili), mungesa e tregtisë (9%) dhe e infrastrukturës, magazinimit dhe e mbështetjes nga shteti (4% secili).

Çështja e tretë më e rëndësishme që u përmend ishte mungesa e ujit të pijshëm (30%), e ndjekur nga ujitja (17%), tregtia (13%), infrastruktura (9%) dhe mungesa e fondeve, rrymës, mekanikës dhe transportit si edhe largësia e madhe nga zonat qytetëse (4% secila).

Çështja e katërt më me rëndësi ishte mungesa e tregtisë (22%), niveli i ulët ekonomik i bashkësisë (17%), mungesa e transportit dhe ujitjes (13% secili), rrugët e vështira (9%), mungesa e fondeve, rrymës dhe tokës, si edhe largësia e madhe nga zonat qytetëse (4% secila).

Çështja e pestë më e rëndësishme ishte largësia e madhe nga zonat qytetëse (35%), mungesa e tregtisë (13%), prania e konkurrencës (9%) dhe mungesa e mjediseve magazinuese, huave dhe tokës (4% secili).

Vlerësimi i institucioneve vendore

Koha e harxhuar për të marrë liçencën ose lejen (P. 16)

Pati vetëm dy përgjigje për këtë pyetje, një person që kishte harxhuar njëzet ditë dhe tjetri një ditë për të marrë lejen.

Çështje të veçanta që prekin sipërmarrjet (P. 17)

Tre problemet më të mëdha për të cilat sipërmarrësit mendojnë që qeveria vendore mund të ndikojë ishin ekonomia joformale (74% thonë që ka ndikim të madh), korrupsioni (57%) dhe kostot e larta (52%). Konkurrenca e pandershme kishte ndikim serioz tek 22% e sipërmarrjeve, ndërsa çështjet e tjera ndiheshin vetëm nga një ose dy biznese.

Çështje që ndikojnë tek mjaft biznese rroknin ndryshimet e shpeshta të rregullave (39%), konkurrencën e pandershme (35%), ekonominë joformale (22%) dhe kërkesa jokonsistente (18%).

Çështjet e tjera nuk kishin asnjë efekt ose vetëm pak efekt tek disa biznese.

Si mund ta ndihmojë komuna sipërmarrjen (P. 18)

Pothuajse të gjitha sipërmarrjet (83%) mendonin që qeveria vendore mund të përmirësonte infrastrukturën, 48% mendonin që mund të përmirësonte politikën tatimore, 9% mendonin se mund të jepte informacion për mundësitë e biznesit dhe vetëm një nga të anketuarit mendonte se mund të përmirësonte procedurat që lidhen me biznesin.

Sa shpesh inspektohen nga autoritetet (P. 19)

Një i anketuar mendonte që asnjë inspektim nga autoritetet vendore nuk ishte i arsyeshëm. Për analizën vijuese nuk u dha asnjë arsye për inspektimet dhe asnjë e dhënë nëse ishte paguar ndonjë gjobë apo ndonjë mitë.

Nëntë sipërmarrje (39%) ishin inspektuar një herë, një sipërmarrje të paktën një herë, në vitin e kaluar nga Drejtoria vendore e Taksave dhe Tatimeve. Në gjashtë nga këto raste inspektimi ishte i arsyeshëm. Gjashtë nga të anketuarit mendonin se një vizitë e tillë nuk aplikohet.

Katër sipërmarrje (17%) ishin inspektuar një herë, një sipërmarrje të paktën një herë vitin e shkuar nga Inspektorati vendor i Shëndetit. Tre nga këto inspektime ishin të arsyeshme, duke përfshirë këtu një përgjigje sipas së cilës nuk ishte bërë një vizitë e tillë. Shtatë sipërmarrje (30%) mendonin që një inspektim i tillë nuk aplikohet.

Gjashtë sipërmarrje (26%) ishin inspektuar një herë dhe një të paktën një herë vitin e kaluar nga zyrtarë të komunës, ku katër nga këto sipërmarrje (67%) ishin inspektuar edhe nga Drejtoria vendore e Taksave dhe Tatimeve (më lart).

Nuk ishte bërë asnjë inspektim nga autoritetet liçencuese, autoritetet mjedisore, policia e qeverisë vendore apo zyrtarë të tjerë. Tetë të anketuar (35%) mendonin që një inspektim nga autoritetet

liçencuese dhe mjedisore nuk aplikohet, shtatë prej tyre mendonin që vizita nga policia vendore nuk aplikohet dhe një prej tyre mendonte që nuk aplikohet asnjë inspektim nga zyrtarë të tjerë.

Faktorë që mbështesin efikasitetin e administrimit (P. 20; shiko Tabelën 1)

Tabela 1. *Pyetja 20: Ju lutemi vlerësoni secilin nga këta faktorë për rolin mbështetës që luajnë në rritjen e efektshmërisë së administrimit të sipërmarrjes suaj*

Faktorë që ndihmojnë biznesin	Pa problem	Pak problem	Shumë problem	E zbrazët
Cilësia e rrugëve			23	
Lejet dhe liçencat për ushtrim veprimtarie	5	13	1	4
Furnizimi me energji elektrike	1		20	2
Furnizimi me ujë			23	
Mjediset ku biznesi është veprues / toka	2	13	5	3
Mbrojtja nga policia	4	8		4
Mbrojtja nga zjarri	5	9	1	8
Planifikimi dhe zonimi urban		9	9	5
Nivelet e taksave	3	12	3	5
Spitalet dhe kujdesi shëndetësor	3	5	10	5
Sistemi arsimor	5	5	9	4
Kostot e telekomunikimit	3	1	15	4
Krimi, vjedhjet dhe mungesa e rendit	4	11	3	5
Cilësia e qeverisjes vendore	13	6		4
Kostot e banimit	1	1	17	4
Mungesa e personelit të kualifikuar	11	8		4
Korrupsioni	7	8	2	6
Aksesi dhe kostot e burimeve financiare		1	18	4
Shërbimet efikase në mbështetje të biznesit	2	13	4	4

Cilësia e rrugëve dhe furnizimit me ujë mendoheshin nga të tërë (pra nga 100%) se ndikonin në administrimin e biznesit. Furnizimi me rrymë ishte vetëm pak më pak tërësor (87%) se sa një problem i madh. Aksesi tek burimet financiare, kostoja e tyre dhe kostot e banimit ishin gjithashtu problem i madh për mjaft prej tyre (përkatesisht 78% dhe 74%), njësoj sikurse kostot për telekomunikime (65%). Kujdesi shëndetësor shihej si problem i madh për 43% të popullsisë dhe si problem i lehtë për 22%. Arsimi shihej si problem i madh nga 39% dhe si problem i vogël nga 22%.

Çështjet e liçencave dhe lejeve, tokës, shërbimeve efikase për mbështetjen e bizneseve, niveleve të taksave, nivelit të krimit dhe mbrojtjes nga zjarri shiheshin më shumë si probleme të lehta nga

përkatësisht 57, 57, 57, 52, 48 dhe 39% e të anketuarve. Planifikimi urban shihej edhe si problem i madh (39%) edhe si problem i vogël (39%) nga të anketuarit. Çështjet e tokës shiheshin si probleme të mëdha nga 22% e të anketuarve. Mbrojtja nga policia shihej ose jo si problem (48%) ose si problem i vogël (35%). Cilësia e qeverisjes vendore dhe mungesa e personelit të kualifikuar shiheshin ose jo si problem (përkatësisht 57%, 48%) ose si problem i vogël (26% dhe 35%), dhe nuk shiheshin fare si problem i madh. Korrupsioni shihej kryesisht si problem i vogël (35%) ose jo si problem (30%), dhe ku vetëm 9% mendonin se ishte problem i madh për efektshmërinë e administrimit të biznesit të tyre. Shërbimet efikase shiheshin si problem i madh vetëm nga 17% e të anketuarve.

Niveli i mbështetjes për SME-të vendore (P. 21)

Rreth një e treta e të anketuarve mendonin që shoqatat e biznesit, Zyra për Zhvillim Ekonomik Rajonal dhe OJF-të nuk kanë qenë në nivel të mirë (përkatësisht 35%, 35% dhe 30%), një pjesë e vogël (17%) e mendojnë këtë për shoqatat profesionale dhe pjesa tjetër që shpreheshin se nuk e dinin ose mendonin se s'kishte lidhje. Për sa i përket qeverisjes vendore kishte një shpërndarje opinionesh ku 13% mendonin se nuk ishte e mirë, 60% se ishte e kënaqshme ose e mirë dhe 9% mendonin se ishte shumë e mirë. 17% e të anketuarve mendonin që shërbimet profesionale private nuk ishin mjaft të mira, ndërsa një pjesë pak më e madhe (22%) mendonin që ishin mjaft të mira. Për sa u përket organizatave ndërkombëtare kishte vetëm një përgjigje ('mirë'), ndërsa shumica e të anketuarve (65%) mendonin që nuk aplikohet.

Niveli i bashkëpunimit me institucionet vendore (P. 22)

Shumica e të anketuarve mendonin që Zyra e Kryetarit dhe Zyra e Komunës për Taksat dhe Financën ishin shumë mbështetëse për sipërmarrjet (përkatësisht 78% dhe 43%), ku një mbështetje pak më e vogël shkonte për Këshillin e Komunës (26% e shihnin si pak mbështetës dhe 30% si shumë mbështetës). Gjithsesi, asnjë nuk mendonte që ndonjë prej këtyre tri zyrave nuk jepte mbështetje. Prefekti dhe Zyra e Taksave të Rrethit shiheshin nga disa si pak mbështetës (përkatësisht 17% dhe 35%) dhe nga pak vetë si jo mbështetës (përkatësisht 4% dhe 13%). Zyra Rajonale për ZhEV shihej nga 22% si jo mbështetëse por nga njëri prej të anketuarve shihej si mjaft mbështetëse. Shumë të anketuar ose nuk dinin ose mendonin se kjo pyetje nuk aplikohet, ose e linin përgjigjen të zbrazët për Prefektin (78%), Zyrën Rajonale ZhEV (74%), Zyrën e Taksave të rrethit (52%), Zyrën e Taksave të Komunës (48%) dhe Këshillin e Komunës (44%).

Zyra vendore që mbështetin sipërmarrjen (P. 23)

Shumica e të anketuarve (70%) përgjigjeshin se nuk dinin ndonjë zyrë që i kishte ndihmuar sipërmarrjet e tyre. Gjithsesi, dy renditën Zyrën e Kryetarit, një Shërbimin e Bujqësisë dhe Veterinarisë dhe një Zyrën e Financës dhe të Taksave.

Zyra vendore që nuk mbështetin sipërmarrjen (P. 24)

Pothuajse të gjithë të anketuarit (87%) nuk dinin për ndonjë zyrë që ndikonte negativisht tek sipërmarrjet e tyre.

Zyra vendore që merren me ZHEV (P. 25)

Shumica e të anketuarve (74%) thanë se nuk dinin ndonjë zyrë në komunë që merrej me zhvillimin ekonomik vendor. Dy të anketuar u shprehën për Zyrën e Kryetarit dhe një u shpreh për Zyrën e Asistencës Sociale.

Grupet më aktive në nxitjen e ZhEV (P. 26)

Dhjetë të anketuar (43%) mendonin që qeveria e komunës ishte shumë vepruese në nxitjen e Zhvillimit Ekonomik Vendor, katër (17%) mendonin për një organizim partneriteti privat-publik, një mendonte për një organizatë private biznesi (si Dhoma vendore e Tregtisë) dhe pesë (22%) nuk e dinin. Nga pesëmbëdhjetë vetë që shenjauan organizimin, nëntë (60%) mendonin që komuna nuk e kishte financuar as pjesërisht atë organizim (duke përfshirë katër që kishin shenjuar ‘komuna’), dhe një që shenjonte ‘Po’ për ‘Komunën’.

Grupi që merret me Zhvillimin Ekonomik Vendor në komunë (P. 27)

Shumica e të anketuarve (78%) mendonin që Zyra e Kryetarit merret me çështjet e Zhvillimit Ekonomik Vendor, ndërsa një mendonte që veprimtaritë e ZhEV janë të deçentralizuara dhe se kryhen nga disa sektorë të komunës.

Pamje të zhvillimit ekonomik

Tri sektorët me rritjen më të shpejtë në komunë (P. 28)

Vetëm katër të anketuar iu përgjigjën kësaj pyetjeje dhe të tërë treguan bujqësinë si sektorin me rritjen më të shpejtë. Tri renditën blegtorinë si të dytën dhe dy prej tyre treguan frutikulturën si sektorin me rritje më të shpejtë.

Tri sektorët me rënien më të shpejtë në komunë (P. 29)

Vetëm një i anketuar iu përgjigj kësaj pyetjeje, duke dhënë në rend zbritës për rënie infrastrukturën e rrugëve, elektricitetin dhe arsimin.

Tri anët më tërheqëse të zhvillimit të sipërmarrjes në komunë (P. 30)

Shumica e të anketuarve (52%) treguan ‘vendndodhjen’ si anën më tërheqëse për zhvillimin e sipërmarrjes në vend, dy (9%) treguan ‘klimën’ dhe një tregoi ‘tokën, pyjet dhe lumin Drin’, ‘ndihmesën’, ‘forcën e punës’, ‘prodhimet cilësore’ dhe ‘administrimin e pronës’.

Anët e dyta më tërheqëse ishin ‘burimet natyrore vendore’ (39%), duke përfshirë ‘dheun, pyjet, kullotat, lumin Drin’, të ndjekura nga ‘aftësitë e komunës’ (13%) dhe ‘lartësia nga deti’ (9%). Anë të tjera që u përmendën një herë ishin ‘prodhimet organike’, ‘zgjerimi i mbështetjes së blegtorisë’, ‘kostot e ulëta’, ‘prodhimi me cilësi të lartë’ dhe ‘klime’.

Anët e treta më tërheqëse ishin ‘rrugët kryesore lidhëse’ (18%), ‘klime’ dhe ‘forca e lirë e punës’ (9%) dhe ‘bujqësia e përmirësuar’, ‘prodhimi organik’ dhe ‘begatia e burimeve natyrore’. Shumica e të anketuarve (52%) nuk treguan ndonjë anë të tretë.

Tri faktorët më pengues (P. 31)

Infrastruktura e dobët ishte faktori më i përmendur (30%) si pengues për zhvillimin e biznesit, i ndjekur nga ujitja e dobët dhe rrugët e këqija (të dyja 22%). ‘Konkurrenca e padrejtë’ u përmend një herë.

Furnizimi i dobët me ujë (si për ujitje dhe ujë të pijshëm) dhe energji elektrike u përmendën si faktorët e dytë më pengues (26% secila), të ndjekura nga infrastruktura e dobët rrugore (22%). Mungesa e ‘kredive’, ‘fondeve’ dhe ‘tregut’ u përmendën nga një herë.

Pati shumë faktorë të tretë më pengues, ku u përmendën mungesa e energjisë elektrike (22%) si më e zakonshme, ndjekur nga rrugët, uji dhe niveli i ulët ekonomik (secila me 17%) dhe më pas mungesa e tregut (13%) dhe mungesa e fondeve (9%).

Ndryshimet në biznes përgjatë tri viteve të fundit (P. 32)

Afërsisht dy të tretat e të anketuarve (65%) mendonin që mjedisi i biznesit nuk kishte ndryshuar përgjatë tri viteve të fundit, ndërsa pjesa tjetër ndahej përgjysmë ndërmjet klimës që përmirësohej dhe asaj në përkeqësim (17% secila).

Tri veprimtari për të kontribuar në zhvillimin ekonomik vendor në komunë (P. 33)

Veprimtaria kryesore që të anketuarit do të ndërmerrnin për të ndihmuar në përmirësimin e zhvillimit ekonomik vendor ishte investimi në rrugë (39%), pasuar nga ujitja dhe furnizimi me ujë të pijshëm (secila 17%). Ndërsa, investimi në energji, asistencë teknike në bujqësi, fuqi punëtore të lirë dhe numri i bagëtive si edhe zgjerimi i aktivitetit ekonomik, u përmendën nga një herë.

Veprimtaria e dytë më e rëndësishme për nga kontributi që u përmend më shpesh ishte investimi në furnizimin me ujë të pijshëm (22%), pasuar nga rruga kombëtare Peshkopi-Kukës (17%) dhe ujitja (13%). Veprimtari të tjera të përmendura nga një herë ishin ‘krijimi i një shoqate’, ‘përmirësimi i cilësisë prodhuese’, ‘rritja e prodhimit’, ‘zgjerimi i kopshteve frutore’ dhe ‘sigurimi i punës stinore’.

Përshkrim i bazës ekonomike në komunë përgjatë pesë viteve të fundit (P. 34)

Të anketuarit kishin një këndvështrim të gjerë për mënyrën se si ka ndryshuar ekonomia përgjatë pesë viteve të fundit. Pikëvështrimi më i zakonshëm (39%) ishte se ka mbetur i pandryshuar, pasuar nga një rritje e ngadaltë (30%), rritje e shpejtë (13%). Katër vetë (17%) nuk iu përgjigjën pyetjes.

KOMUNA ZALL DARDHË, QARKU DIBËR